



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВА - REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
МИНИСТАРСТВО ПОЛЈОПРИВРЕДЕ, ШУМАРСТВА И РУРАЛНОГ РАЗВОЈА  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT  
Arkivi Qendror - Centralna Arhiva - Central Archive

Nr./Br./No. 5489/2  
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 1+55  
Data/Datum/Date: 29.12.2023  
PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister**

Datë: 29.12.2023

Ref. KM-473/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10, 11 dhe 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11. Shtojcën 1: pika 11 të Rregullores (QRK)-NR.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (16.08.2023), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

**V E N D I M**

**Për miratimin e Planit vjetorë të menaxhimit me pyje për vitin 2024**

1. Miratohet Plani Vjetor i menaxhimit me pyje për vitin 2024.
2. Obligohet Agjencia pyjore e Kosovës - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



*Vendimi i dërgohet:*

- Fidan Dema,
- Kabinetit të Ministrit,
- Zyrës së Sekretarit Përgjithshëm,
- Agjencisë Pyjore të Kosovës, dhe
- Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVËS - ШТАТОВА КООСОВА - REPUBLIC OF KOSOVA  
 QEVERIA E KOSOVËS - ВЛАДА КОСОВА - GOVERNMENT OF KOSOVO  
 MINISTRIA E PYLLTARISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
 MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
 MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT  
 Arkivi Qendror - Centralno Arhivo - Central Archive

Nr./Br./No. 5489  
 Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 54  
 Data/Datum/Date: 29.12.2023  
 PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA



REPUBLIKA E KOSOVËS - ШТАТОВА КООСОВА - REPUBLIC OF KOSOVO  
 MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
 MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
 MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT  
 АГЈЕНЦИЈА ПУЈОРЕ Е КОСОВËS АГЕНЦИЈА ЗА ШУМЕ КОСОВА/KOSOVO FOREST AGENCY  
 Arkivi - Arhivo - Archive

Nr./Br./No. 8500  
 Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 54  
 Data/Datum/Date: 29/12/2023  
 Prishtinë /a

Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
 MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
 MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

  
 Agjencia Pyjore e Kosovës  
 Agencija za Šume Kosova  
 Kosovo Forest Agency

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	DE-2664/2023				
PËR/ZA/TO:	Faton Peci, Ministër i MBPZHR-së				
CC:					
NGA/OD/FROM:	Fidan Dema, Ud. Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë Pyjore të Kosovës (APK)				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani Vjetor për Menaxhim me Pyje për vitin 2024				
Nr. i zyrës:		Lokacioni:		Data:	
Br. kancelarije:	10	Kucni:	Prishtinë	Datum:	29.12.2023
Room No.:		Extension:		Date:	

I nderuar Ministër,

Bashkangjitur gjeni për miratim Planin Vjetor për Menaxhim me Pyje për vitin 2024.

Me respekt!



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**  
**QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT**

**MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
**MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE. SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA**  
**MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT**



**Agjencia Pyjore e Kosovës**  
**Agencija za Šume Kosova**  
**Kosovo Forest Agency**

---

# **PLANI VJETOR I**

# **MENAXHIMIT ME PYJE PËR**

# **VITIN 2024**

---

Dhjetor 2023






REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT



Agjencia Pyjore e Kosovës  
Agencija za Šume Kosova  
Kosovo Forest Agency

## PLANI VJETOR I MENAXHIMIT ME PYJE PËR VITIN 2024



Drejtoria për Menaxhim me Pyje

Menderes IBRA, Drejtor



Agjencia Pyjore e Kosovës

Fidan DEMA, Ud. Drejtor Ekzekutiv

Dhjetor, 2023  
Prishtinë

## Shkurtesat

MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
APK	Agjencia Pyjore e Kosoves
DMP	Drejtoria për Menaxhim me Pyje
DKR	Drejtoria Koordinuese Regjionale
DQIPGJ	Drejtorati Qendror i Inspektionit për Pylltari dhe Gjueti
DHPPPF	Drejtorati për Hulumtime, Projektme në Pyje dhe Prodhim Fidanor
DMKEKGJET	Drejtorati për Menaxhim me Kafshë të Egra, Kulloso, Gjueti dhe Ekoturizëm
NjKP	Njësia Komunale Pyjore
IKP	Inventarizmi Kombëtar i Pyjeve
NjM	Njësi Menaxhuese
PMP	Plani Menaxhues i Pyjeve (Planet Menaxhuese Afatgjata)
PVMP	Plani Vjetor për Menaxhim me Pyje
DPVMP	Draft Plani Vjetor për Menaxhim me Pyje
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
FAO	Food and Agriculture Organization
CNVP	Connecting Natural Values and People
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
JICA	Japan International Cooperation Agency
Eco-DRR	Ecosystem based Disaster Risk Reduction
EULEX	European Union Rule of Law Mission
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
PKPRP	Programi Kombëtar i Pyllëzimit dhe Ripyllëzimit
PPJD	Produktet Pyjore Jo Drunore
VGJRV	Vend Gjueti me Rëndësi të Veçantë
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare
PK	Parku Kombëtar
UA	Udhëzim Administrativ
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
ZKF	Zyrtari Kryesor Financiar
KE	Kryeshef Ekzekutiv
DFSHP	Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme i APK-së
DP	Departamenti i Pylltarisë - MBPZHR

## HYRJE

Plani vjetor i menaxhimit të pyjeve hartohet për të gjitha pyjet dhe tokat pyjore, duke u bazuar në programet dhe planet menaxhuese të pyjeve, për secilin vit vijues. Planifikimi i menaxhimit me pyje është operacion i rëndësishëm, dhe grup aktivitetesh komplekse e të koordinuara, të cilat ekzekutohen duke përdorur metodologji të caktuara për grumbullimin, analizimin dhe përpunimin e të dhënave dhe informatave, me qëllim të përgatitjes së planeve për menaxhim me pyje.

Përmes zbatimit të këtij dokumenti, synohen që të përmbushen objektivat kryesore të punës së APK-së, të cilat rrjedhin nga mandati ligjor i saj, por edhe nga dokumentet kryesore afatmesme e afatgjata të zhvillimit të sektorit të pylltarisë. Prioriteti kyç jo vetëm i PVMP, por edhe i angazhimit të gjithmbarshëm të APK-së, dhe i gjithë sektorit të pylltarisë është menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe tokave pyjore si resurse shumë të rëndësishme. Me pyjet dhe toka pyjore nevojitet menaxhimi i qëndrueshëm shumë funksional, duke ruajtur dhe avancuar shumëllojshmërinë biologjike të tyre, pasi që në këtë mënyrë ruhet ambienti dhe ngritët cilësia e jetës së njerezve. Për shkak të rëndësisë së veçantë sektori i pylltarisë duhet të trajtohet si sektor strategjik shtetëror, i cili përveç të tjerash kontribuon, edhe në stabilitetin social dhe në rritjen e nivelit të sigurisë në vendin tonë.

Koncepti i menaxhimit të qëndrueshëm dhe të integruar të pyjeve, konsiston ndër të tjera në përcaktimin e balancit në mes të shfrytëzimit ekonomik të pyjeve krahas kapaciteteve regjeneruese, përkatësisht përdorimit, shfrytëzimit dhe menaxhimit të tyre sot, konform nevojës për ruajtjen e potencialit të tyre për të ardhmen.

Parimi kryesor i PVMP-se, është që në një rën anë të merren parasysh kërkesat e qytetarëve për furnizim me dru për ngrohje, pastaj të industrisë përpunuese për dru teknik, duke u bazuar në aspektet afatgjata të shfrytëzimit të pyjeve konform gjendjes së tyre. Në këtë mënyrë, përmes kësaj qasjeje dhe trajtimeve adekuate silvikulturore arrihet krijimi i rendit pyjor, dhe rritjes së vazhdueshme të vlerës së pyjeve. Përmes zbatimit të PVMP-se do të realizohen funksionet themelore të pyjeve, duke përfshirë ato ekonomike, mjedisore, dhe shoqërore.

PVMP-ja është hartuar mbështetur në bazën ligjore nga Ligji për Pyjet nr.08 / L-137, akteve nën-ligjore dhe Udhëzimeve Administrative, si dhe normave, standardeve dhe udhëzimeve profesionale. PVMP është i hartuar bazuar në nenin 29 të Ligjit 08/L-137 për pyjet, dhe është në harmoni me synimet, standardet dhe menaxhimin e pyjeve të përcaktuar në nenin 5.6 dhe 7 të këtij Ligji, sipas kërkesave të legjisllacionit, dhe gjendjes së grumbujve pyjor në ngastrat e Njësive Menaxhuese (Njësive ekonomike pyjore), të propozuara nga DKR-të të APK-se. Evidentimi i ngastrave pyjore për trajtim nga aspekti silvikulturore, i mbrojtjes dhe shfrytëzimit të pyjeve, përkatësisht, zgjedhja dhe damkimi i trungjeve për prerje, në ngastrat e propozuara për këtë plan vjetor, është bërë gjatë vitit 2023.

Të dhënat në PVMP janë konform të dhënave sipas planifikimit, zgjedhjes dhe damkimit të trungjeve për prerje, trajtimeve të pyjeve të reja, mbrojtjes etj, për secilën ngastër të planifikuar në vitin 2023 për vitin 2024.

Disa nga dispozitat e Ligjit për Pyjet e Kosovës 08/L-137 që rregullojnë çështjen e planifikimit dhe menaxhimit me pyje janë të përfshira në nenet: 26,27,28,29,30, 31,32 dhe 33.

Mjetet financiare për realizimin e PVMP 2024 sigurohen nga buxheti shtetëror.

## TË DHËNAT KRYESORE TË FONDIT PYJOR TË KOSOVËS

Të dhënat e mëposhtme rrjedhin nga Inventarizimi Kombëtar i Pyjeve në Kosovë i vitit 2012. DMP ka kërkuar në vazhdimësi hartimin IKP, sepse: “Qëllimi kryesor i Inventarizimit Kombëtar të Pyjeve të Kosovës, është që të promovojë një menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve, duke vlerësuar resurset totale të pyjeve, dhe lartësinë e prerjeve vjetore të qëndrueshm, e si dhe të ofrojë informacione për qeverinë për të ndihmuar zhvillimin e sektorit pyjor, për të vlerësuar qëndrueshmërinë e menaxhimit të pyjeve dhe për të përmbushur detyrimet e mundshme ndërkombëtare të raportimit në shfrytëzimin e tokës”.

*Grafikoni 1: Sipërfaqja e përgjithshme e Kosovës sipas klasave të përdorimit:*




Tabela 2: Origjina e grumbullit dhe sipërfaqja sipas pronësisë / ha

Origjina e grumbullit	Pronësia në hektar (ha)			Totali ha
	Shtetërore	Private	Padefinuar	
Farim natyral	58,400	13,600	1,000	73,000
Pyllëzim dhe farim artificial	2,000	800	0	2,800
Cungishte	229,000	164,800	4,000	397,800
Cungishte me standarde	5,800	1,600	0	7,400
<b>Totali</b>	<b>295,200</b>	<b>180,800</b>	<b>5,000</b>	<b>481,000</b>

Tabela 1: Sipërfaqja e përgjithshme sipas klasave të përdorimit të tokës:

Klasat e përdorimit të tokës	Viti 2012	
	ha	%
Pyje	481,000	44,7
Tokë tjetër pyjore	29,200	2,7
Tokë bujqësore	309,000	28,7
Livadhe/kulloso	161,400	15,0
Vendbanime	48,000	4,5
Ujë	5,200	0,5
Tokë tjetër e lagësht	800	0,1
Tokë tjetër	42,400	3,9
Jo-klasifikuar	0	0,0
<b>Totali</b>	<b>1,077,000</b>	<b>100</b>

- Nga sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve prej 481,000 ha, rreth 295,200 ha ose rreth 62% janë në pronësi shtetërore, ndërsa rreth 38% ose 180,800 ha janë në pronësi private.
- Pyjet e llojeve fletorë mbulojnë më shumë se 90% të sipërfaqes pyjore dhe llojet dominuese të fletorëve të fortë janë: Dushqet (*Quercus spp.*), Ahu (*Fagus spp.*), Frashëri (*Fraxinus*), Shkoza (*Carpinus*) etj, dhe fletorë të butë: Mështekna (*Betula pendula*), Panja (*Acer spp.*), Bliri (*Tilia spp.*), Verri (*Alnus spp.*) etj. Pyjet halore mbulojnë rreth 7% të sipërfaqes totale pyjore ku dominojnë llojet: Bredhi (*Abies Alba*), Hormoqi (*Picea abies*), llojet e Pishës (*Pinus spp.*) etj.
- Vëllimi total në këmbë në pyje sipas inventarizimit kombëtar është vlerësuar për klasa diametrike dhe llojet drusore gjatë vitit 2012.

Tabela 3: Vëllimi në këmbë sipas llojeve dhe klasa diametrike (1000 m<sup>3</sup>)

Llojet	Klasa diametrike						Totali
	7-10	10-20	20-30	30-50	50-70	>70	
<i>Quercus cerris</i>	592	1 686	923	872	127	83	4 282
<i>Querus petraee</i>	365	1 539	880	644	169	72	3 669
<i>Quercus spp.</i>	245	646	164	57	143	37	1 292
<i>Fagus spp.</i>	494	2 559	3 077	6 244	3 840	2 311	18 524
Fletorë tjerë	883	2 274	1 233	1 246	372	742	6 750
<i>Abies alba</i>	34	216	364	660	183	117	1 573
<i>Picea abies</i>	45	286	487	829	193	0	1 840
<i>Pinus spp.</i>	28	181	468	1 195	472	159	2 502
Halorë tjerë	2	10	8	57	0	0	77
<b>Totali</b>	<b>2,688</b>	<b>9,397</b>	<b>7,604</b>	<b>11,804</b>	<b>5,499</b>	<b>3,521</b>	<b>40,508</b>



Rritja vjetore e pyjeve sipas Inventarizimit Kombëtar të Pyjeve në vitin 2012:

Tabela 4: Sipërfaqja, vëllimi në këmbë dhe rritja vjetore sipas grupit të llojeve dhe pronësisë (ha, m<sup>3</sup>/ha, %)

Pronësia	Llojet e drunjëve sipas grupeve								
	Halorë			Fletorë			Përzier		
	sipërf.	vëll./ha	rritja	sipërf.	vëll./ha	rritja	sipërf.	vëll./ha	rritja
Shtetërore	21 000	209	3.1	266 000	80	3.2	7 000	251	3.5
Private	2 600	152	3.8	177 200	68	3.7	600	342	3.1

Sipas Inventarizimit Kombëtar:

PK "Sharri" PK "Bjeshkët e Nemuna"	Njësia matëse	Totali
Sipërfaqja pyjore	ha	59,600
Vëllimi në këmbë	m <sup>3</sup>	14,300,000
Pjesëmarrja në sipërfaqen e përgjithshme të pyjeve	%	12
Vëllimi	%	36

Gjatë viteve të kaluara, sektori i pylltarisë ka kaluar nëpër faza të ndryshme të zhvillimit, si nga aspekti organizativ institucional, e edhe nga ai i menaxhimit.

Në vitin 2012 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar dy ligje për parqet kombëtare, ku zona e pyjeve në Malet e Sharrit është zgjeruar edhe për 20,000 ha, si dhe Ligjin për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". Në total, dy PK përfshijnë sipërfaqen prej rreth 125,000 ha. Vështruar nga perspektiva dhe zhvillimet e sektorit të pylltarisë, këto dy ligje kanë shkaktuar ndryshime të mëdha në sektorin e pylltarisë, pasi që pothuajse të gjitha pyjet e larta janë brenda territorit të këtyre dy PK, dhe si pasojë edhe planifikimi për shfrytëzimin e pyjeve në sektorin shtetëror është zvogëluar në masë të konsiderueshme. Me aprovimin e këtyre dy ligjeve, sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve e përfshirë në kuadër të PK arrin në rreth 28%. Për të krahasuar gjendjen, mjafton të shikohet situata në shtete evropiane, ku zakonisht sipërfaqja e pyjeve e përfshirë në PK është 1.5-3% e totalit të pyjeve. Bazuar në gjendjen aktuale, duhet nënvizuar se në mungesë të ekspertizës dhe menaxhimit profesional të pyjeve në PK, rrezikohet që të shkaktohen dëme të mëdha ekonomike dhe në rrëgjimin e vlerës së pyjeve.

Të dy PK janë nën kompetencë të MMPHI. Duke ditur se pothuajse i tërë potenciali kadrovik i ekspertëve të pylltarisë në vend është i punësuar në APK, është evidente se ekspertiza dhe përvoja e tyre në menaxhimin e sektorit të pylltarisë, sot nuk përdoret në PK. Vlerësojmë se është e nevojshme që të bëhet një punë e përbashkët dhe koordinim efektiv, sidomos në sferën profesionale në mes të MMPHI dhe MBPZHR-së /APK-së, në sferën e menaxhimit të pyjeve. Në nenin 27 të Ligjit për pyje, pika 5 thuhet se Plani i menaxhimit të pyjeve në Parkun Kombëtar zbatohet përmes planeve vjetore dhe projekteve të hartuara në bazë të Ligjit për Pyje, Ligjeve për Parqet Kombëtare dhe Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës.

APK, sipas Ligjit për Pyjet e Kosovës, menaxhon dhe administron me pyje dhe toka pyjore shtetërore dhe kryen shërbime teknike dhe profesionale të planifikimit në pyjet private.

APK për çdo vit harton PVMP dhe pas diskutimit me palët në sektor, i aprovon Planet Vjetore të Menaxhimit me Pyje, dhe operacionale për menaxhim e ngastrave të planifikuara për trajtim, duke

filluar nga trajtimi i pyjeve të reja, pyllëzimeve, shfrytëzimit, dhe të gjithë aktiviteteve që parashihen për ngastrat pyjore konform Planeve Menaxhuese Pyjore.

PVMP për vitin 2024 përbëhet nga 12 kapituj, të cilat njëkohësisht janë edhe plane në vetëvete (8 kapitujt e parë gjithashtu përbëhen nga forma tabelore):

1. **Kultivimi i pyjeve;**
2. **Trajtimi (Shfrytëzimi) i pyjeve në ngastra;**
  - Shfrytëzimi i ngastrave nëpërmjet tenderimit dhe shitjes së masës drusore për furnizim me dru djegie për nevoja familjare;
  - Prodhimi neto, ndarja sipas asortimenteve drusore dhe prodhimi bruto, prerjet sipas NjKP;
  - Prerjet sipas llojeve të trajtimeve;
3. **Aktivitetet në trajtimin e pyjeve të reja (rrallime paratregtare, pastrime etj.);**
4. **Pyllëzimet;**
5. **Prodhimi i fidanëve dhe gjendja e stokut ;**
6. **Aktivitetet në pyje private;**
7. **Mbrojtja e pyjeve;**
8. **Hartimi i Planeve Menaxhuese Pyjore (Planeve Afatgjata);**
9. **Infrastruktura pyjore;**
10. **Shfrytëzimi i produkteve pyjore jodrunore;**
11. **Fauna (Gjuetia);**
12. **Trajnimet dhe**
13. **Kostoja Financiare.**

## 1. KULTIVIMI I PYJEVE

PVMP në aspektin e kultivimit të pyjeve, përmban të gjitha aktivitetet, të cilat caktohen në bazë të obligimit që rrjedhin nga planet e menaxhimit (planet afatgjata), dhe përshtatjen e tyre me kushtet financiare, teknike dhe mundësitë kadrovike për realizimin e tyre, si dhe koordinimi i bashkëpunimit me projektet e donatorëve.

Qëllimi i këtyre aktiviteteve të planifikuara me planin e kultivimit të pyjeve është:

1. Kultivimi dhe përtëritja e pyjeve, (punët përgatitore dhe masat ndihmëse për përtëritjen e pyjeve, trajtimi i kulturave pyjore dhe trajtimi i pyjeve të reja dhe plotësimi me pyllëzime);
2. Trajtimi \ shfrytëzimi i pyjeve, (shfrytëzimi i pyjeve në ngastra, sipas llojeve të trajtimeve sipas metodologjisë së PMP, konvertimi dhe prerja me shirita (breza) apo në formë rrethore);
3. Ngritja e pyjeve të reja, (Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhevshura dhe ripyllëzimi);
4. Mbrojtja e pyjeve si masë preventive nga faktorët biotik dhe abiotik;
5. Rritja e kualitetit dhe prodhimit, dhe
6. Përkujdesi gjithëpërfshirës për pyjet dhe tokat pyjore në funksion të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, sipas parimeve të përshkruara në nenin 10 të Ligjit për Pyjet e Kosovës, zvogëlimi–parandalimi i prerjeve ilegale dhe furnizimi i qytetarëve me dru zjarri për nevoja familjare etj.

Me këtë plan, gjatë vitit 2024 është planifikuar vëllimi i punimeve të ndryshme silvikulturore:

- A. Kultivimi i pyjeve në sipërfaqe prej: 1,409.90 ha si dhe 4.5 km pastrim të rrugëve dhe shtigjeve pyjore.
- B. Trajtimi i pyjeve: 5,409.10 ha, dhe
- C. Ngritja e pyjeve të reja 105.03 ha

Plani i kultivimit të pyjeve në tërësi planifikohet të realizohet në sipërfaqe gjithsej: 6,924.03 ha. Sipas Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të APK-se dhe organizatës së CNVP-se, planifikohen të realizohen 5 ha pyllëzime, ku të gjithë obligimet do të merren nga CNVP-ja .

*Plani i aktiviteteve në kultivimin e pyjeve*

Nr.	Regjioni	Kultivimi i pyjeve/ha	Trajtimi i pyjeve/ha	Ngritja e pyjeve të reja/ha	Gjithsej/ha
1	Prishtinë	176,50	488,10	10,00	674,60
2	Mitrovicë	268,00	1350,06	15,00	1633,06
3	Pejë	80,00	1203,25	20,00	1303,25
4	Prizren	595,50	696,70	25,03	1317,23
5	Ferizaj	85,00	1219,50	20,00	1324,50
6	Gjilan	192,90	283,88	15,00	491,78
7	DMKEKGJET	12,00	167,61	0,00	179,61
<b>Gjithsej</b>		<b>1409.90</b>	<b>5409.10</b>	<b>105.03</b>	<b>6924.03</b>

*Foto nga kultivimi-rigjenerimi i pyjeve*



## 2. TRAJTIMI (SHFRYTËZIMI) I PYJEVE NË NGASTRA PYJORE

### 2.1. Shfrytëzimi i ngastrave përmes tenderimit dhe shitjes së masës drusore për furnizim me dru djegie për nevoja familjare.

Vëllimi i prerjeve në nivel të NjM, DKR-ve dhe nivel vendi, planifikohet në bazë të inventarizimit të pyjeve, planeve menaxhuese pyjore afatgjata si dhe gjendjes faktike në terren, bazuar në strategjinë e zhvillimit të pylltarisë .

Në këtë vit, APK ka hartuar Planin mbi bazën e nënngastrave dhe ngastrave të PMP-ve për Njësitë Menaxhuese Pyjore, të cilat janë në fuqi, ndërsa për pyjet tjera në mungesë të Planeve Menaxhuese Pyjore Afatgjata, nënngastrat janë zgjedhë sipas elaborateve të vjetra, si dhe bazuar në gjendjen faktike nga terreni, ku është bërë zgjedhja dhe damkimi i drurëve për prerje gjatë vitit 2023 për planin e vitit 2024, pra për të gjitha ngastrat e përfshira për trajtim me lloje të ndryshme të prerjeve. PVMP dhe plani operacional, përgatiten mbi bazën e të dhënave nga PMP, dhe gjendja faktike nga terreni që rrjedh nga damkimi i drurëve për prerje në ngastrat e përfshira me këtë plan, të cilat do të aprovohen konform neneve 10 dhe 30 (pikat 1 dhe 2) si dhe nenin 52 pika 1. të Ligjit për Pyjet e Kosovës.

Në bazë të dokumenteve të pranuar nga DKR-të , disa nga faktorët që pamundësojnë planifikimin më të madh të shfrytëzimit të pyjeve janë:

1. Dëmet e shkaktuara në pyje nga prerjet ilegale;
2. Gjendja momentale e pyjeve (pjesa qendrore e pyjeve në Kosovës janë kryesisht pyje të reja, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e pyjeve të larta kualitative janë brenda PK);
3. Mungesa e stafit tekniko-profesional;

Me PVMP për vitin 2024 planifikohet të realizohet, masa drusore bruto si në vijim:

- Shfrytëzimi i ngastrave pyjore nëpërmjet tenderimit: 43,010.57 m<sup>3</sup>;
- Shfrytëzimi i ngastrave pyjore, furnizim me dru djegie për ekonomi familjare 17,803.40 m<sup>3</sup>;
- Planifikimi i masës drusore të daluar nga Rallimet para tregtare: 2,092.50 m<sup>3</sup>;

Gjithsej shfrytëzimi i ngastrave pyjore në pronësi shtetërore: 62,908.89 m<sup>3</sup>;

- Planifikimi shfrytëzimit në pyje me pronësi private: 173,490 m<sup>3</sup>.
- Planifikimi shfrytëzimit në pyje private brenda Parqeve: 5,240 m<sup>3</sup>;


**PVMP për vitin 2024 në të dy sektorët ka vëllimin bruto: 241,638.89 m<sup>3</sup>.**

Shitja e masës drusore me pakicë, furnizim me dru për djegie për nevoja familjare, është e rregulluar sipas UA-14/2011, (sipas kërkesave të parashtruara për furnizim me dru zjarri për nevojat e ekonomive familjare, në zonat malore dhe rurale do të lejohet shitja me pakicë e drurit të zjarrit dhe e mbeturinave drusore, sipas planeve operationale për secilën ngastër, ku kjo jep mundësi për pastrime të pyjeve nga mbeturinat, dhe njëkohësisht parandalon sëmundjet dhe dëmtuesit).

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit të ri për pyjet Nr 08/L-137, përkatësisht neni 58 dhe 49, për prerje në pyjet publike brenda territorit të Parqeve Kombëtare dhe zonave të mbrojtura të natyrës, me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional, APK ka organizuar takim me DE të AMMK-se dhe dy drejtorët e Parqeve Kombëtare, për PVMP në këtë sferë. Konkluzion i takimit ka qenë që të dy Drejtoritë e Parqeve Kombëtare të sjellin kërkesat në DKR-të përkatëse të APK-



së lidhur me sasinë e planifikuar të prerjeve sanitare për vitin 2024. Sidoqoftë, drejtoritë e Parqeve Kombëtare i paraqiten kërkesat me vonesë, dhe DKR-të e APK-së, për shkak edhe të kushteve klimatike në terren dhe kohës së shkurtër, e nuk ishin në gjendje të verifikojnë sasinë e planifikuar që drejtoritë e Parqeve Kombëtare kishin kërkuar për përfshirje në PVMP. Për shkak të kësaj, stafi udhëheqës i APK-se në takimin me drejtoret e tri DKR-ve (Prizren, Pejë dhe Ferizaj), vendosi që në këto kushte, për vitin 2024 në PVMP të përfshihen vetëm kërkesat për prerje në pyjet private, kurse për pyjet shtetërore, kërkesat nga Parqet Kombëtare të bëhen më herët gjatë vitit 2024, me qëllim të verifikimit nga DKR-të e APK-së me kohë dhe të përfshirjes së tyre në PVMP të vitit 2025.



2.2. *Prodhimi neto i Asortimenteve drusore si dhe prodhimi bruto i ndarë në nivele të DKR-ve :*

Tabela e prodhimit neto i asortimenteve drusore, jep të dhënat në nivel të DKR-ve, ku përshkruan planifikimin apo ndarjen e llojeve të drunjeve, dhe llojeve të ndara në asortimenteve në dru teknik dhe dru zjarri, të përshkruara si më poshtë:

*Pasqyra e prodhimit neto sipas asortimenteve drusore dhe e ndarë nëpër DKR:*

Nr.	ASORTIMENTI	Drejtoria Koordinuese Regjionale							
		Prishtinë	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Ferizaj	Gjilan	DMKKEGJET	Gjithsej
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9 (2+8)
1	<b>Dru teknik fletore</b>	90.10	734.00	49.60	58.10	4,488.89	3,229.51	133.48	8,783.68
	Ahu	90.10	734.00	49.60	58.10	4,488.89	2,967.51	29.70	8,417.90
	Dushku (Bung, Qarr)						180.00	74.98	254.98
	Shkozë								-
	Mështekën								-
	Fletorë tjerë të forte						82.00	1.33	83.33
	Fletorë tjerë të butë							27.47	27.47
2	<b>Dru teknik halorë</b>	206.40	-	-	117.40	-	963.52	-	1,287.32
	Hormoqi						662.60		662.60
	Bredhi				41.70				41.70
	Pisha e zeze	201.40			75.70		300.92		578.02
	Halorë te tjerë	5.00							5.00
3	<b>Dru teknik të tjerë</b>	-	-	-	-	-	18.40	-	18.40
	Fletore								-
	Halore						18.40		18.40
4	<b>Dru zjarri fletore</b>	4,543.37	11,092.50	4,453.80	4,624.05	9,049.71	9,544.05	3,288.49	46,595.97
	Ahu	3,201.12	9,088.00	2,214.60	3,449.15	8,919.71	5,342.05	64.17	32,278.80
	Dushku (Bung, Qarr)	360.85	2,004.50	2,167.20	95.10	130.00	3,952.00	2,812.68	11,522.33
	Shkozë	591.40		72.00	379.10		250.00		1,292.50
	Mështekën				278.40				278.40
	Fletorë tjerë të forte	390.00			352.00			3.56	745.56
	Fletorë tjerë të butë				70.30			408.08	478.38
5	<b>Dru zjarri halorë</b>	1,038.50	557.28	191.70	148.30	70.50	801.05	-	7,765.78
	Hormoq		46.38	171.00			183.00		400.38
	Bredh				15.60				15.60
	Pisha e zeze	888.50	510.90	20.70	122.10		618.05		2,160.25
	Hartinë				10.60	70.50			81.10
	Pseudotsugn				4,947.85				4,947.85
	Halorë te tjerë	150.00			10.60				160.60
	<b>GJITHSEJ MASA M3:</b>	<b>5,878.37</b>	<b>12,383.78</b>	<b>4,695.10</b>	<b>4,947.85</b>	<b>13,609.10</b>	<b>14,556.53</b>	<b>3,421.97</b>	<b>59,492.70</b>

Në tabelën bruto jepen të dhëna për asortimentet të ndara, dru teknik për fletorë, halorë dhe dru teknike tjerë, si dhe dru zjarri për fletorë dhe halorë sipas llojeve. Gjithashtu, në këto të dhëna përfshihet edhe masa drusore nga rrallimet para-tregtare dhe mbetjet drunore. Këto të dhëna janë në formën tabelore në nivele të DKR-ve, si dhe janë në formën tabelore në Excel me te detajuar për NjKP.

*Pasqyra e prodhimit bruto e ndarë sipas Drejtorive Koordinuese Regjionale të APK-së*

Nr. R	Njesia Komunale	Llojet e drurit	Neto m <sup>3</sup>				mbetje drimore m <sup>3</sup>	Vëllimi bruto gjithsej m <sup>3</sup>
			dru teknik	rrollimet paratregtare	dru zjarri	Gjithsej		
0	1	2	3	4	5	6 (3+4+5)	7	8 (6+7)
<b>I Drejtorati Koordinuese Regjional Prishtinë</b>								
Gjithsej I		Halor	206.40	-	1,032.20	1,238.60	62.95	1,301.55
		Fletor	96.50	520.00	4,023.27	4,639.77	210.42	4,850.19
<b>TOTAL:</b>			<b>302.90</b>	<b>520.00</b>	<b>5,055.47</b>	<b>5,878.37</b>	<b>273.37</b>	<b>6,151.74</b>
<b>II Drejtorati Koordinuese Regjional Mitrovicë</b>								
Gjithsej II:		Halor	-	-	557.28	557.28	29.56	586.84
		Fletor	734.00	455.00	10,637.50	11,826.50	599.81	12,426.31
<b>TOTAL:</b>			<b>734.00</b>	<b>455.00</b>	<b>11,194.78</b>	<b>12,383.78</b>	<b>629.37</b>	<b>13,013.15</b>
<b>III Drejtorati Koordinuese Regjional Pejë</b>								
Gjithsej III:		Halor	-	-	191.70	191.70	21.30	213.00
		Fletor	49.60	202.50	4,251.30	4,503.40	440.80	4,944.20
<b>TOTAL:</b>			<b>49.60</b>	<b>202.50</b>	<b>4,443.00</b>	<b>4,695.10</b>	<b>462.10</b>	<b>5,157.20</b>
<b>IV Drejtorati Koordinuese Regjionale Prizren</b>								
Gjithsej IV:		Halor	117.40	-	148.60	266.00	14.00	280.00
		Fletor	58.10	-	4,623.75	4,681.85	246.42	4,928.27
<b>TOTAL:</b>			<b>175.50</b>	<b>-</b>	<b>4,772.35</b>	<b>4,947.85</b>	<b>260.42</b>	<b>5,208.27</b>
<b>V Drejtorati Koordinuese Regjional Ferizaj</b>								
Gjithsej V:		Halor	-	-	70.50	70.50	3.90	74.40
		Fletor	4,488.89	130.00	8,919.71	13,538.60	709.78	14,248.38
<b>TOTAL:</b>			<b>4,488.89</b>	<b>130.00</b>	<b>8,990.21</b>	<b>13,609.10</b>	<b>713.68</b>	<b>14,322.78</b>
<b>VI Drejtorati Koordinuese Regjional Gjiçan</b>								
Gjithsej VI:		Halor	1,063.92	-	801.05	1,864.97	126.47	1,991.44
		Fletor	3,147.51	785.00	8,759.05	12,691.56	797.28	13,488.84
<b>TOTAL:</b>			<b>4,211.43</b>	<b>785.00</b>	<b>9,560.10</b>	<b>14,556.53</b>	<b>923.75</b>	<b>15,480.28</b>
<b>VII Drejtorati për Menaxhim me Kafshë të Egra, Gjueti, Kullosa dhe Ekoturizëm</b>								
Gjithsej VII:		Halor	-	-	-	-	-	-
		Fletor	133.48	-	3,288.49	3,421.97	153.50	3,575.47
<b>TOTAL:</b>			<b>133.48</b>	<b>-</b>	<b>3,288.49</b>	<b>3,421.97</b>	<b>153.50</b>	<b>3,575.47</b>
Gjithsej APK: I-VII		Halor	1,387.72	-	2,801.33	4,189.05	258.18	4,447.23
		Fletor	8,708.08	2,092.50	44,503.07	55,303.65	3,158.01	58,461.66
<b>TOTALI</b>			<b>10,095.80</b>	<b>2,092.50</b>	<b>47,304.40</b>	<b>59,492.70</b>	<b>3,416.19</b>	<b>62,908.89</b>

Disa arsye që janë duke ndikuar në mos realizimin e planeve për shfrytëzim të masës drusore në pyje, përkatësisht në mos-rritjen e tij, pasi që nga viti në vit PVMP në sektorin shtetëror nuk po realizohet sipas planit. Pengesat kryesore në këtë drejtim janë:

- Miratimi i dy ligjeve për shpalljen e dy PK: Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna, si dhe kalimi i tyre nën menaxhimin e MMPHI, ka ndikuar në uljen e planifikimit dhe shfrytëzimit të pyjeve. Në kuadër të dy PK gjenden pyje kualitative, përkatësisht ndodhet mbi ¼ e sasisë së përgjithshme të masës drusore.
- Mos realizimi i planit vjetor të shfrytëzimit të pyjeve në sektorin shtetëror nga komunat, (mos publikimi i tenderëve, apo publikimi me vonesë i tyre, kapaciteti i pamjaftueshëm i komunave me staf dhe mjete teknike për të menaxhuar procesin e shfrytëzimit të pyjeve, kapacitetet e ulëta teknike të operatorëve ekonomik për shfrytëzim të pyjeve etj).
- Mungesa e një entiteti / kompanie publike që merret me shfrytëzimin e pyjeve;
- Infrastruktura e pamjaftueshme rrugore për shfrytëzim adekuat të pyjeve, (kostoja e lartë financiare për investime në hapje të rrugëve dhe shtigjeve të reja pyjore);

- Mos parashtrimi i kërkesave nga palët e interesit, për rritje të planifikimit të shfrytëzimit të masës drunore;
- Problemet e theksuara në zbatimin e ligjit dhe në menaxhimin me pyje shtetërore në komunat: Zubin Potok, Zveqan dhe Leposaviq.

### 3. TRAJTIMI I PYJEVE TË REJA (rrallime para tregtare, pastrime, çlirime etj.)

Trajtimet silvikulturore në pyjet e reja \ prerjet kulturore si; rrallimet paratregtare, pastrimet, çlirimet janë me interes për vendin tonë, duke pasur parasysh që pjesë të mëdha të pyjeve janë të dominuara kryesisht me pyje të reja.

Me planin për rrallime para tregtare për vitin 2024 do të trajtohet sipërfaqja prej 412.80 ha, dhe do të nxirret vëllimi i vlerësuar i masës drusore prej 2092.50 m<sup>3</sup>, dru zjarri, dhe nga kjo sasi do të përfitojnë rreth 129 familje.

Trajtimi i pyjeve të reja bëhet në disa forma të realizimit, si, përmes tenderimit, përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit, si dhe përmes menaxhimit të përbashkët të pyjeve.

Trajtimi përmes prerjeve kulturore në pyje është heqja selektive e drurëve, së pari për të përmirësuar ritmin e rritjes apo shëndetin e drunjëve të mbetur. Pastaj, rrallimi mund të bëhet edhe për të rritur rezistencën e drunjëve ndaj faktorëve të mjedisit siq janë thatësira, insektet apo temperaturat ekstreme etj.

Qëllimi kryesor i prerjeve kulturore është kujdesi ndaj grumbullit pyjor. Nxjerrja e drurëve është mjet dhe jo qëllim.

Duke pasur parasysh që nga këto trajtime varet suksesi i zhvillimit të pyllit, disa nga rregullat që do të zbatohen në përzgjedhjen e drurëve të ardhmërisë janë:

- Nga pylli të nxirren trungjet më pak të vlefshëm, dhe me cilësi të dobët;
- Përparësi për mbetje në pyll kanë trungjet me prejardhje nga fara - nëse ka;
- Trungjet e specieve dytësore – ndihmëse nuk duhet të hiqen tërësisht;
- Nuk këshillohet rrallim i theksuar, kurordendësia 0.7 - 0.8;
- Nënpylli duhet mbajtur;
- Për të rritur prodhimtarinë në të ardhmen, duhet mbajtur drurët me cilësi të mirë;
- Për përmirsimin e gjendjes sanitare, nxirren drurët e sëmurë - nëse ka, etj.

Është e rëndësishme, si në çdo aktivitet që lidhet edhe me sipërfaqen, edhe në trajtimin e pyjeve të reja (rrallime para tregtare, pastrime \ çlirime), të gjitha DKR-te të APK-së, t'i evidentojnë në formë digjitale, dhe ato të përcillen në DMP në formë të kopjes fizike dhe digjitale, (në formë të vijave dhe pikave koordinative). DMP mund të mbështetë në aspektin profesional DKR-të me trajnim të shkurtër rreth kësaj, dhe lidhur me implementimin e këtij procesi.



Pamje nga trajtimi i pyjeve të reja dhe rigjenerimit të halorëve dhe fletorëve:



#### 4. PLANI I PYLLËZIMEVE

Është me rëndësi të madhe sigurimi i regjenerimit të pyjeve pas shfrytëzimit të tyre. Kjo përfshinë sjelljen pa vonesë të drurëve të rinjë, të llojit adekuat dhe me një densitet të kënaqshëm (periudha e rigjenerimit). Kjo duhet të vendoset me një kosto dhe mënyrë efikase. Përmes praktikave të duhura mund të rriten mundësitë për një rigjenerim të shpejtë dhe të suksesshëm.

Krijimi i pyjeve të reja është një prej aktiviteteve më komplekse në pylltari. Faktorët siç janë zgjedhja e lokacionit, karaktersitikat e tokës, klima, materiali për mbjellje, teknikat e mbjelljes dhe koha e përshtashme, duhet që gjithësesi të merren parasysh gjatë procesit të pyllëzimit.

Ngritja e pyjeve të reja, përveç se lidhet me rritjen e fondit pyjor, gjithashtu kontribuon edhe në ekosistem.

Edhe pse përmenden faktorë të ndryshëm, është e rëndësishme të potencohet që përqindja e e zënies së fidanëve, nuk është duke ofruar sukses krahasuar me planifikimin. Për të ndërprerë këtë dukuri, është planifikuar që nga viti 2023 ngastrat që pyllëzohen, të buxhetohen edhe për mirëmbajtje për një periudhë 3 vjeçare. Këto janë praktika dhe standarde profesionale që zbatohen edhe në vendet tjera.

Plani i pyllëzimeve, është pjesë e PVMP i planifikuar nga DKR-të, i cili nderlidhet edhe nga Programi Kombëtar për Pyllëzim dhe Ripyllëzim 2018-2027, nevojave të DKR-ve dhe gjendjes faktike në terren. Planifikimi i pyllëzimeve për vitin 2024 poshtë është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Parakushtet për pyllëzime të suksesshme janë:

Studimi i parakushteve për krijimin e pyjeve të reja ndihmon në zgjedhjen llojeve dhe metodën e shfrytëzimit. Disa nga faktorët e rëndësishëm për planifikim të llojeve janë: Toka, klima, lartësia detare, kundrejtimi, vegjetacioni përreth etj.

Në këtë mënyrë do të eliminohet mundësia që sipërfaqet e njëjta të mbivendosen me aktivitete të njëjta, dhe kjo do rrisë efektivitetin dhe planifikimin adekuat në sferën e pyllëzimeve.

Disa nga arsyet pse duhet të ketë pyllëzime janë:

- Krijohen lloje të përshtatshme të drurëve dhe grumbujve pyjorë;
- Ripyllëzimin apo plotësimin e grumbujve pyjorë të degraduar nga prerjet ilegale, nga zjarret apo fatkeqësitë natyrore;
- Mbrojtjen e tokës nga rrëshqitjet apo erozioni;
- Për të siguruar një shpërndarje të njëjtë të drurëve me cilësi të mirë dhe prodhues;
- Rritje të fondit pyjorë.

*Planifikimi i pyllëzimeve nga APK.*

Nr. rendor	DKR të APK-së	Sipërfaqja		Numri i fidaneve për pyllëzim					Gjithsej
		ha	Mosha	P. zezë	Hartinë	Bredh	Hormoq	Ahu	
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9(4-8)
1	Prishtinë	10,00	1+1	25 000					25000
2	Mitrovicë	15,00	1+1		37 500				37 500
3	Pejë	20,00	2+0	25 000			25 000		50 000
4	Prizren	20,03	1+1			11 850		38 225	50 075
5	Ferizaj	20,00	2+0	25 000	25 000				50 000
6	Gjilan	15,00	2+0	37 500					37 500
<b>Gjithsej:</b>		<b>100,03</b>		<b>112 500</b>	<b>62 500</b>	<b>11 850</b>	<b>25 000</b>	<b>38 225</b>	<b>250 075</b>

Siq shihet dhe në tabelën sipër, planifikimi i aktiviteteve të cilët do të realizohen nga APK, nëpërmjet formës së tenderimit, është në sipërfaqe 100.03 ha, të cilët janë të shpërndarë në të gjithë territorin e vendit.

*Planifikimi i pyllëzimeve nga donatorët*

Nr. rendor	DKR të APK-së-Komuna	Sipërfaqja		Numri i fidaneve për pyllëzim											Gjithsej	Vërejtje
		ha	Mosha	P. zezë	Hartinë	Bredh	Hormoq	Geshenje dhe arr	Ahu	Bagrem	Bung i kun	Qarri	Bungu	Larshi		
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	10	11	12	13(4-12)	14	
1	Dragash	5,00														CNVP
<b>Gjithsej:</b>		<b>5,00</b>														

1.Projekti i pyllëzimeve me projektin e organizatës së CNVP-së do të realizohet në Komunën e Dragashit.

2.Përcaktimi i llojeve dhe metodologjisë do të bëhet në bashkëpunim me projektin CNVP. Orientimisht llojet do jenë: Bredhi, Pseudotsuga, Larshi, Ahu, Dushqet.

3.Nga zbatimi i projektit të trajtimit të pyjeve të degraduara me CNVP, mund të rezultojë nevoja për plotësime me fidanë, gjë e cila do realizohet sipas nevojës konkrete gjatë implementimit të projektit. Në këtë periudhë, nuk mundemi të përcaktohem specifikisht për llojin dhe sasinë e fidaneve.

Të gjitha sipërfaqet e planifikuara për pyllëzim në të gjitha DKR-te, duhet të evidentohen në formë digjitale, dhe ato të përcillen në DMP në formë të kopjes fizike dhe digjitale, (në formë të vijave dhe pikave koordinative).

Në këtë mënyrë do të eliminohet mundësia që sipërfaqet e njëjta të mbivendosen me aktivitete të njëjta, dhe kjo do rrisë efektivitetin dhe planifikimin adekuat të pyllëzimeve.



## 5. PRODHIMI I FIDANËVE DHE GJENDJA E STOKUT

Sipas planifikimit nga DHPPPF, gjatë vitit 2024, do të prodhohen gjithsej 1.002.000 fidane. Prej tyre do të jenë:

- Fidanë industrial - 553,500
- Fidanë klasike - 448,500

*Planifikimi i prodhimit të fidanëve në DHPPPF*

Nr. rendor	Lloji i fidanëve	Mënyra e prodhimit	Total
1	Halorë	Industriale	553,500
2	Halorë	Klasike	348,500
4	Fletorë	Industriale	-
5	Fletorë	Klasike	100,000
<b>Gjithsej</b>			<b>1.002.000</b>

Lidhur me shtrirjen e pyllëzimeve DMP, rithekson rëndësinë e zbatimit të kriterëve të mëposhtme rreth përcaktimit të ngastrave ku do të kryhen pyllëzimet, me theks të veçantë në:



- Në toka pyjore të zhveshura dhe me kualitet të mirë, dhe aty ku për fidanët e mbjellura nuk paraqiten rreziqe të theksuara nga faktorët e jashtëm;
- Në pyje dhe toka pyjore, aty ku pyjet janë të vjetra, joproductive dhe të degraduara;
- Në pyje dhe toka pyjore ku regjenerimi natyral nuk pritët të arrihet brenda një periudhë kohore të arsyeshme;
- Në vende me shkurre dhe bimësi të ulët;

Është e rëndësishme të planifikohet që pyllëzimi i siperfaqeve pyjore të dëmtuara nga faktorët e ndryshëm si p.sh. zjarri, prerjet ilegale etj, si dhe toka të zhveshura, duhet të bazohet në

përzgjedhjen e metodave adekuate, si dhe të bëhen analizat reale të kostos të pyllëzimeve, pastaj analiza e rreziqeve potenciale që u kërcënohen fidanëve etj.

Për shkak të rëndësisë së kultivimit të llojeve të drunjëve autokton, dhe për shkak se farërat e tyre janë të përshtatshme për adaptim në kushtet tona klimatike dhe pedologjike, synohet që të fillohet së shpejti në DHPPPF, grumbullimi, trajtimi i farërave dhe prodhimi i fidaneve të llojeve të drunjtëve autokton.

*Foto: Pamje nga prodhimi i fidanëve industrial, gjysemindustriale dhe atyre klasike në fidanishten e DHPPPF Pejë:*





## 6. RREGULLIMI I PYJEVE NË PRONËSI PRIVATE

Plani i punëve tekniko-profesionale për pyjet private, do të zbatohet me kujdes, duke pasur parasysh se edhe këto resurse pyjore janë pjesë e resurseve kombëtare pyjore.

Punët tekniko-profesionale që planifikohen të kryen në pyjet private janë:

- a) Kontroll dhe verifikim i lëndës, konkretisht verifikim nëse në të njëjtat ngastra sipas kërkesës ka pasur shfrytëzimit të të njëjtave ngastra në vitet paraprahe;
- b) Vlerësimi i grumbullit pyjor (ngastrës) për damkim;
- c) Zgjedhja dhe damkosja e trunjeve për prerje, nga DKR-të;
- d) Dhënia e lejeve për prerje nga NJKP sipas kërkesave të pronarëve të pyjeve private;
- e) Damkimi në stivë dhe dhënia e dokumentacionit përcjellës nga NJKP-të, për transport të masës së lejuar drunore nga pylli;
- f) Përcjellja e gjendjes shëndetësore të pyjeve private;
- g) Dhënia e këshillave profesionale;
- h) Hartimi i programeve për pyllëzim etj.

Gjatë vitit 2024 në aspektin e shfrytëzimit të pyjeve private, planifikohet, përzgjedhja e drunjëve, damkimi dhe dhënia e lejes për prerje të drunjëve, në sasinë me vëllim bruto: 173,490 m<sup>3</sup>. Kurse në të dy Parqet Kombëtare, planifikohet përzgjedhja e drunjtëve, damkimi dhe dhënia e lejes për prerje të drunjtëve me vëllim bruto prej 5,240 m<sup>3</sup>.

Në aspektin e kultivimit të pyjeve në pronësi private, planifikohen të pyllëzohen 60 ha. Këto aktivitete do të detajohen në programet e pyllëzimit, që do të hartohen sipas kërkesave të pronarëve të pyjeve private në bashkëpunim dhe koordinim në mes DKR-ve dhe DHPPPF.

## 7. MBROJTJA E PYJEVE

Prerjet e drunjëve, dhe aktivitetet tjera ilegale në pyje, dhe toka pyjore janë sfida më e madhe dhe problemi kryesor me të cilën ballafaqohet APK dhe i tërë sektori i pylltarisë.

Ndalimi i dëmtimit të pyjeve do të jetë edhe në vitin 2024 një nga detyrat parësore të DKR-ve për monitorim, vlerësim, raportim dhe informim të APK-se sipas Ligjit mbi Pyjet 08/L-137 .

Aktivitetet e planifikuara në mbrojtjen e pyjeve nga prerjet dhe dëmtimet tjera ilegale do të jenë në harmoni me mandatin dhe kompetencat ligjore, dhe do të konsistojnë në ndërmarrjen e masave bazuar në aktet ligjore .

### 7.1. Aktivitetet e APK-së në mbrojtjen e pyjeve e tokave pyjore do të fokusohen në:

- Bashkëpunimi dhe koordinimi i punëve brenda të gjitha njësive organizative të APK-së, mirëpo edhe me institucione tjera brenda sektorit, me qëllim të monitorimit dhe kontrollimit të pyjeve dhe tokave pyjore, e shfrytëzimit të tyre sipas destinimit dhe në harmoni me bazën ligjore;
- Në të gjitha terrenet e rojeve të pyjeve, së paku një herë në vit, e në rastet e veçanta sipas kërkesave specifike, bëhet regjistrimi i terreneve pyjore, nga, DKR-të, përmes komisioneve për kontroll dhe regjistrim të dëmeve pyjore, uzurpimeve e dëmeve tjera në pyje e toka pyjore;

- Lidhur me mbrojtjen e shëndetit pyjor nga të gjitha rreziqet potenciale, (duke përfshirë mbrojtjen nga sëmundjet, dëmtuesit, si dhe faktorët abiotikë), DKR-të, do të kryejnë monitorimin e gjendjes shëndetësore të pyjeve, me qëllim të identifikimit me kohë të sëmundjeve dhe dëmtuesve, apo të çrregullimeve tjera shëndetësore në pyje. Pas kësaj do të bëhet njoftimi i DHPPPF me qëllim të diagnostikimit të saktë dhe planifikimit të ndërmarrjes së masave adekuate.
- Bazuar në planet e DKR-ve për vitin 2024 është planifikuar që në mbrojtjen e pyjeve të përfshihet sipërfaqja prej 295.90 hektarë, prej të cilës, 53,00 hektarë nga faktorët abiotik dhe 148.90 hektarë nga faktorët biotik. Gjithashtu është planifikuar vendosja e 94 trunjeve kurth. (të dhënat e detajuara gjenden në pjesën tabelare). Këto masa mbrojtëse kanë koston e vet financiare, dhe duhet që të kenë edhe mbështetjen përkatëse buxhetore. Duke pasur parasysh gjendjen në terren, prezencën e dëmtuesve dhe të sëmundjeve aktualisht në ngastra të caktuara, dhe efektet e ndryshimeve klimatike globale të cilat me shpejtësi dhe intenzitet të lartë po paraqiten edhe në vendin tonë, vlerësojmë se në vitin 2024, ekziston rrezik i zgjerimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve. Duhet të ndahet buxheti i mjaftueshëm për luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve, dhe për shkak të specifikave të patogjenëve, të nënshkruhet kontratë kornizë me kompani të specializuara që do të ofroj shërbimet në kohën e duhur, si dhe konform kriterve profesionale.

*Foto. prekje e llojeve të halorëve nga dëmtuesit:*



## 7.2. Mbrojtja e pyjeve nga zjarri

- Duke pasur parasysh shkallën e paraqitjes së zjarreve në pyje viteve të fundit, si dhe rreziqet dhe dëmet e shkaktuara nga to, do të ndërmerren veprime të cilat ndikojnë në pengimin e paraqitjeve të zjarreve, ose në rast të paraqitjes së tyre, veprimin e menjëhershëm për zvogëlim të dëmeve. Një ndër shkaqet e paraqitjes së zjarreve qëndron edhe në efektin e ndryshimeve gjithnjë e më të theksuara klimatike globale. Nga këto rrethana jo favorizuese nuk mund të përjashtohet as vendi ynë, prandaj duhet që të jemi maksimalisht të angazhuar në këtë drejtim;
- Varësisht nga mundësitë buxhetore, APK do të sigurojë 50 uniforma dhe pajisje tjera për shuarjen e zjarreve. Këto uniforma do të jenë të kompletuara dhe të ngjashme me ato të zjarrfikësve, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes gjatë shuarjes së zjarreve, ku varësisht nga rastet e paraqitura në terren, të punësuarit e APK-së, krahas zjarrfikësve dhe AME-së, vullnetarisht do të merrnin pjesë në shuarjen e zjarreve.

- Ritheksojmë nevojën e pajisjes së institucioneve përkatëse (Zjarrfikësit, AME, Policia etj) me mjete të duhura për shuarjen e zjarreve në pyje, e për të qenë efikas në shuarjen e zjarreve në mbrojtjen e pyjeve, nevojitet edhe helikopteri për shuarjen e zjarreve (i quajtur edhe traktor ajror);
- Me qëllim të preventivës të mbrojtjes nga zjarri, në PVMP të vitit 2024 planifikohet hapja e brezave kundër zjarrit në gjatësi prej 13.10 km, dhe mirëmbajtja e atyre ekzistuese në gjatësi prej 20.60 km, si dhe parashihen rreth 5,916 ditë pune kujdestari aktive, në periudhën e rrezikshmërisë së lartë nga zjarret, sidomos në periudhën Maj – Tetor ( po potencojmë se realizimi i kujdestarisë, do të bëhet i mundur nëse arrihet Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të APK-së dhe MFPT);
- Të gjitha sipërfaqet e përfshira nga zjarret pyjore, duhet që të raportohen nga DKR-të në DMP. Raporti duhet të përmbajë të dhënat rreth sipërfaqes, grumbujve pyjor të përfshirë në zjarr, shkallën e dëmeve, si dhe vlerësimin e vlerës ekonomike-financiare të tij. Këto të dhëna (sidomos sipërfaqja e grumbullit pyjor sipas klasave të menaxhimit të pyjeve, kufijtë, duhet të jenë në formë të vijave dhe pikave koordinative), nga DKR-të. Në këtë mënyrë, do të kemi të dhëna të sakta, dhe në kohë reale, për pozicionin gjeografik të zjarreve pyjore, grumbullit pyjor dhe nivelit të dëmeve të shkaktuara nga zjarret.
- APK-DKR konform nenit 38 për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri do të hartoj Planin për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri e nivel të njësisë menaxhuese apo të komunës për periudhën dhjetë (10) vjeçare.
- Agjencia në bashkëpunim me institucionet kompetente për mbrojtje nga zjarri, merr pjesë në punën rreth parandalimit dhe monitorimit të zjarreve pyjore.
- DKR-të konform UA 22/2007, Për Mbrojtjen e Pyjeve nga Zjarri, do të punoj që të hartohen Planet Vjetore të Mbrojtjes së Pyjeve dhe Tokave Pyjore nga Zjarri. Këto plane duhet që të hartohen dhe miratohen nga DKR-të deri më 28.02.2024, duhet që të përmbajnë të gjitha kërkesat specifike sipas këtij UA. DKR-të pas hartimit të këtyre planeve të njëjtin duhet ta përcjellin në DMP deri më 30.03.2024.
- Gjithashtu, gjatë vitit 2024, nëse ka mjete buxhetore, APK si masë parandaluese ndaj zjarreve në pyje, planifikon edhe ngritjen e 36 vrojtoreve dhe së paku të 9 ujëmbledhësive.

*Pamje nga dëmtimi i pyjeve nga zjarret pyjore:*



## 7.3 MBROJTJA E NATYRËS

Bazën për planifikim të punës në lëmin e mbrojtjes së natyrës dhe ambientit e përbëjnë konventat ndërkombëtare, ligjet ekzistuese dhe gjendja momentale e ekosistemeve natyrore si faktor që ndikojnë në mjedis.


Kontribut i veçantë për ruajtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor do të jetë menaxhimi i pyjeve në pajtim me deklaratën e parimeve për konsensusin global mbi menaxhimin, ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve të dhëna në aneksin III nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin dhe Zhvillimin (Rio de Zhaneiro të vitit 1992), që ka të bëjë me parimet vijuese:

- Parimi parandalues;
- Ruajtja e shumëllojshmërisë biologjike;
- Parimi i barazisë ndërbrezore;
- Zhvillimi ekologjik i qëndrueshëm;



## 8. HARTIMI I PLANEVE MENAXHUESE AFATGJATA

APK në vazhdimësi bën organizimin e përgatitjes së hartimit të PMP për Njësi Menaxhuese.



Për këtë vit, sipas kërkesave të DKR-ve, Planet Menaxhuese Afatgjate për Njësitë Menaxhuese duhet të planifikohen në sipërfaqe: 136,564.60 ha, të financuar nga buxheti i APK-së. Mirëpo, mjetet financiare në dispozicion sipas buxhetit të këtij viti, dhe bazuar në çmimet e viteve paraprake, nuk janë të mjaftueshme për realizim të gjithë sipërfaqes. Prandaj, këtë vit duke parë mundësinë eventuale të ndryshimit të metodologjisë për hartimin e Planeve Menaxhuese Pyjore, përkatësisht në fillimin me plane menaxhuese shumëqëllimore pyjore, financiarisht do të mund të realizohen vetëm rreth 1/4 e sipërfaqes së planifikuar.

Gjithashtu, sipas nenit 27 të Ligjit për pyjet, pika 4, Plani Menaxhimit në Parkun Kombëtarë hartohet nga APK dhe miratohet nga Ministria, me pëlqim të Ministrisë përgjegjëse për Mjedis.

Gjithashtu, në bashkëpunim me projektin "Mbështetje në fuqizimin e menaxhimit të qëndrueshëm dhe shumëqëllimor për të përmirësuar jetesën në vendet rurale dhe për të adresuar ndryshimin klimatik në Kosovë"- i implementuar nga FAO janë hartuar tri draft plane për tri NjM si pilot njësi për hartimin e Planeve Menaxhuese Shumëqëllimore. Këto Njësi Menaxhuese janë: Novobërda (Novobërdë), Kovaqica (Mitrovicë) dhe Biraqa (Suharekë).



Tabela për hartimin e Planeve Menaxhuese Pyjore:

Nr.	DKR	NjKP	NjM	Sipërfaqja ha	
0	1	2	3	4	
1	Prishtinë	Podujevë	Turuçicë	7,835.00	
		Prishtinë	Prishtina II	2,078.60	
		Lipjan	Prishtina III	1,558.40	
2	Mitrovicë	Mitrovicë	Pvjet e Lipjanit	7,107.00	
		Vushtrri	Kopaunik	5,444.80	
		Zveçan	Oqavica	2,816.30	
		Leposaviq	Stolovi	3,442.80	
			Denkovac II	4,180.50	
			Mala Reka	1,785.50	
3	Prizren	Prizren	Jarik-Belo Brdo	6,321.00	
			Koxha Ballkan	4,664.75	
			Koretnik I	598.56	
		Dragash	Malet e Sharrit	4,235.90	
			Koretnik II	1,873.00	
			Bredhiku	793.00	
4	Ferizaj	Suharekë	Koka Ahut	3,435.70	
		Ferizaj	Zhegoc	1,340.50	
		Shtime	Dremjak-Mollopolc	1,495.00	
5	Gjilan	Shterpc	Topill-Devetak	2,743.60	
		Gjilan	Verbeshticë-Kashtanievë	5,514.30	
		Ranillug	Zhegoc	5,329.00	
		Kamenicë	Ranillug	4,258.40	
			V.Vrh-K.Reka	4,157.10	
			Shavarinka	4,702.50	
6	Pejë	Pejë	Ruselija	3,624.72	
			Zhlep	5,249.62	
			Kopranik	6,252.40	
			Haila	7,263.30	
		Deçan	Pleqe - Qeli	1,834.93	
			Pvjet e Strelcit	1,022.82	
			Kozhner - Roshkodol	4,129.10	
		Gjakovë	Lloqan - Deçan	2,933.80	
			Maja - Gllava	827.00	
			Pashtriku II	5,041.70	
			Junik	Pvjet e Junikut	3,444.00
			Istog	Lugu i Butë	5,058.00
7	DMKEKGJET	VGJRV	Blinaja	2,172.00	
<b>Gjithsej</b>				<b>136,564.60</b>	

DMP rekomandon që në bashkëpunim me DP të MBPZHR-së, të shikohet mundësia që NjM Dramjak-Mollopolce të ndahet në dy NjM sipas komunave perkatëse.

Kryerja e PMP sipas tabelës të mësipërme do të jetë në varësi të burimeve financiare-buxhetore. Në këtë kontekst, prioritet në hartimin e PMP do të kenë ato NjM të cilat kanë potencial më të lartë të shfrytëzimit dhe afati i vlefshmërisë të të cilave u ka skaduar më moti.

Paisjet për mbledhjen e të dhënave taksative për hartimin e PMP






## 9. INFRASTRUKTURA PYJORE

Ndërtimi i infrastrukturës pyjore duhet të jetë në funksion të krijimit të rrjetës optimale të rrugëve dhe shtigjeve pyjore, në bazë të konfiguracionit të terrenit dhe resurseve pyjore të planifikuara për trajtim.

Planet e kultivimit dhe shfrytëzimit të pyjeve, gjithmonë duhet të përcillen edhe me planet e ndërtimit të infrastrukturës pyjore, i cili duhet të jetë i paraqitur në hartë dhe bashkangjitur në planin operativ.

Planifikimi i infrastrukturës rrugore pyjore do të konkretizohet me planet operationale për ngastrat e planifikuara për trajtim.

*Realizimi i mirëmbajtjes të rrugës me standarde në VGJRV Blinajë:*



Gjatë vitit planifikues 2024, është planifikuar që të bëhet mirëmbajtje e rrugëve ekzistuese prej 3 km në DKR Mitrovicë, 19.50 km në DKR të Prizrenit, 6 km në DKR Gjilan, dhe 12.08 km në DMKEKGJET, pra, në total 40.58 km.

Gjithashtu është planifikuar, që të bëhet edhe hapja e rrugëve të reja në gjatësi totale prej 4.00 km, përkatësisht 1 km në DKR Mitrovicë dhe 3.00 km në DKR Gjilan.

## 10. SHFRYTËZIMI I PRODUKTEVE PYJORE JO-DRUNORE

Shfrytëzimi i produkteve pyjore jo-drusore paraqet një aspekt të rëndësishëm ekonomik për banorët e viseve rurale, dhe po ashtu mund të krijojë të hyra financiare shtesë në buxhet. Këto produkte zakonisht në masë të madhe eksportohen, duke gjeneruar kështu të hyra, dhe duke krijuar vende të reja të punës.

Mënyra, kushtet, përmbajtja dhe çmimi i lejes për grumbullimin e produkteve pyjore jo drunore, si dhe llojet e shfrytëzimeve, janë të përcaktuara në Udhezimin Administrativ nr .11/2023.

Kontigjentet e produkteve pyjore jo drunore janë sasi të natyrë dhe në vlerë të planifikuara në një vit kalendarik, për t'u vjelë apo grumbulluar nga pyjet dhe tokat pyjore, që rezultojnë nga

zbatimi i planeve të menaxhimit, nga projektet e studimet e veçanta. Këto kontigjente mund të vilen, grumbullohen, vetëm atëherë kur nuk cenohet zhvillimi i qëndrueshëm i fondit pyjor e kullosor dhe dëmtimi i mjedisit.

Vlerësimi i planifikimit vjetor të produkteve pyjore jo drunore, është detyrë e çdo DKR-je, në kuadër të planifikimit të rregullt vjetor të punëve dhe aktiviteteve të saj, në territorin të cilin e mbulon.

Produktet pyjore jo drunore, në lloje dhe sasi të që do të grumbullohen në një vit kalendarik, do të përcaktohen nga çdo DKR për Njesi menaxhuese, mbështetur në planet përkatëse të përditësuara të inventarizimit. Potencialet do të evidentohen për 5-10 llojet kryesore të PPJD-ve, që janë objekt grumbullimi.

Sipas nenit 8 të UA 11/2023, pika 3: Agjencia bënë analizimin e të dhënave statistikore të çmimit të shitjeve të PPJD-ve në bazë vjetore, dhe përcakton çmimin mesatar të tregut për secilen kategori apo lloj të PPJD-ve që mbledhen. Kurse në piken 3 thuhet: Periudha e përcaktimit të çmimit fillon nga 31 marsi i vitit aktual të mbledhjes dhe përfundon me 30 mars të vitit të ardhshëm.

Gjithashtu në nenin 5 pika 1 dhe 2 të UA të sipërmendur theksohet: Agjencia harton projektin e shfrytëzimit të PPJD-ve dhe funksioneve tjera të pyllit. Projekti nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të hartohet në harmoni me Udhëzimin Administrativ përkatës për Planifikimin e Menaxhimit të Pyjeve.

Në nenin 14, paragrafi 1 të UA të lartpërmendur theksohet: Ministria me propozimin e Agjencisë miraton dhe rishqyrton here pas here metodologji për mbledhjen e llojeve të caktuara të PPJD-ve, në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare që Ministria i konsideron të përshtatshme, duke përfshirë Fair Wild, EO Organic, FSC ose të tjera.

Duke pasur parasysh këto dhe nenet tjera të UA në fjalë, si dhe faktin se ky UA ka hyrë në fuqi me 7 tetor 2023, në takimet e stafit udhëheqës të APK-së, si dhe në takimet me drejtorët e DKR-ve të APK-së, është diskutuar gjerësisht rreth planifikimit të shfrytëzimit të PPJD-ve në PVMP, dhe përgatitjeve që duhet bërë nga APK në planifikimin e këtyre punëve. Duke pasur parasysh kufizimet kohore të lart cekura në UA, pastaj faktin se në APK do të fillohet për hetë të parë me organizimin e grumbullimit të PPJD-ve, dhe veçanërisht mungesën e stafit në DMP dhe në DKR, e gjithashtu edhe mungesën e një inventarizimi të PPJD-ve në nivel vendi, (pasi që inventarizimi i fundit i tyre është bërë nga donatorët në vitin 2014), atëherë konkluzionet e stafit udhëheqës të APK-se, lidhur me përfshirjen e PPJD-ve në PVMP të vitit 2024 është si vijon: Në vitin 2024 nuk mund të fillohet me aktivitetet konkrete në grumbullimin e PPJD-ve, mirëpo do të ndërmerren të gjitha aktivitetet përgatitore, për të filluar të përgatitur këtë punë në vitin pasardhës, duke e përfshirë në PVMP. Andaj, në këtë drejtim aktivitetet përgatitore që do të ndërmerren në vitin 2024 do të jenë:

Organizimi i një takimi me të gjithë pjesëmarrësit në sektor, duke përfshirë grumbulluesit, përpunuesit, eksportuesit dhe institucionet tjera, me qëllim të grumbullimit të informacioneve relevante rreth PPJD-ve, sikurse janë çmimet, llojet, sasi të grumbulluara, përpunuara etj.

Do të kerkojm nga Ministria, që të kryhet inventarizimi i PPJD-ve në nivel vendi, në mënyrë që të sigurojmë bazën e të dhënave për PPJD, duke përfshirë potencialin prodhues, kuotat, llojet, metodologjinë e grumbullimit etj.

Përgatitja e Draft Metodologjisë për mbledhjen e llojeve të caktuara të PPJD-ve, dhe dërgimi i saj në Ministri për miratim.

Hartimi i procedurave të brendshme mbi të dhënat: Lëshimin e lejeve, sasi të PPJD-ve të mbledhura dhe çmimet e mbledhjes.

Për produktet e PPJD-ve, mundësitë vjetore të vjeljes së tyre nga pylli, do të përcaktohen me projekte të veçanta në nivel n/ngastre apo Njësie menaxhuese pyjore, hartuar nga seksionet teknike të DKR-ve.

Projekti hartohet në harmoni me UA përkatës për planifikimin e menaxhimit të Pyjeve.

## 11. FAUNA (GJUETIA)

Fauna kontribuon në pasurimin e biodiversitetit të ekosistemit. Për faunën, pylli përfaqëson ushqimin dhe strehimin e saj. Fauna mund të ndikojë mbi pyllin pozitivisht ose negativisht, direkt ose tërthorazi.

Menaxhimi i kafshëve të egra është rregulluar me Ligjin për Gjueti, andaj nga konteksti i mandatit së APK-së, kjo do të koordinohet edhe me aktivitetet pyjore të cilat kryhen, udhëhiqen dhe monitorohen nga APK-ja. Duke pasur parasysh kompetencat e rojeve të pyllit në sferën e gjuetisë, do të kërkohet raport së paku dy herë në vit nga komunat për gjendjen rreth gjuetisë, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e situatës momentale, si dhe numrin e fletëparaqitjeve të ngritura për personat që veprojnë në kundërshtim me Ligjin e Gjuetisë, përkatësisht me UA të detyrave dhe përgjegjësive të rojeve të pyllit.

Kjo bëhet për arsye të gjuetisë ilegale dhe të pakontrolluar në shumë komuna, dhe të rrezikut të pakësimit drastik të numrit të kafshëve të egra, madje edhe duke rrezikuar zhdukjen e tërësishme të disa specieve. Në këtë mënyrë, do të mund të vijë, edhe deri te rrezikimi i ekzistencës të popullacionet të disa llojeve të faunës së egër. Njesia Menaxhuese "Blinaja" në bazë të potencialit gjeografik, kushteve gjeologjike, pedologjike, hidrologjike dhe karakteristikave të reliefit e të klimës, afron kushte shumë të volitshme për kultivimin e një numri të caktuar të botës shtazore, kryesisht të gjitarëve të cilët janë të rrezikuar nga zhdukja dhe janë atraktive dhe të kërkuara për gjueti.

Llojet reprezentative të faunës në NJM "Blinaja" janë: Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Derri i egër (*Sus scrofa*), Dreri brilopatë (*Dama dama*), Dreri i rëndomtë (*Cervus elaphus*). Përveq llojeve të kultivuara brenda kësaj njësie takohen edhe lloje tjera dhe shpendë të ndryshëm si: Shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), Shqiponja perandorike (*Aquila heliaca*), Dallëndyshja e natës (*Caprimulgus europaeus*) etj.

Pas miratimit të Ligjit për gjueti, shumica nga komunat kanë arritur t'i themelojnë vend gjuetive të përbashkëta me përjashtim të disa komunave të cilat kanë zvarritur proceset në themelimin e tyre, ndërsa ka neglizhencë nga Kuvendet Komunale në zhvillimin e procedurave ligjore për dhënin e tyre në menaxhim, por vitet e fundit pas presionit pozitiv të DQIPGJ ky proces është intensifikuar dhe tani veç janë dhënë në menaxhim një numër i konsideruar i tyre.

Bazuar në të dhënat zyrtare të cilat janë siguruar nga Menaxherët e Vend gjuetive të përbashkëta, përkatësisht Drejtorët e Drejtorive respektive Komunale ku janë të sistemuara Sektorët për pylltari, për gjithsejtë 13 (trembëdhjetë) vend gjueti aktive të dhëna në menaxhim (në Therandë SHGJ "GALLUSHA" në Kamenicë SHGJ "KAMENICA" në Gjilan SHGJ "PETRITI", SHGJ "KARADAKU-AGIM RAMADANI" dhe SHGJ "UJKU", në Kaçanik SHGJ "LYBETENI" në Han të Elezit/ SHGJ "KRONI I FTOHTË", në Lipjan LINDJE, në

Kastriot SHGJ "ROSA" në Fushë Kosovë SHGJ "BJESHKA", në Mitrovicë SHGJ "SHALA" dhe në Vushtrri dy vend gjueti SHGJ "ÇYÇAVICA").

Sipërfaqja e përgjithshme e gjuetisë është 238,843 hektarë, (prej tyre 106,729 hektarë në pronësi shtetërore dhe 132,114 hektarë në pronësi private).

## 12. PLANI I TRAJNIMEVE

Duke pasur parasysh dinamikën e punëve në sektorin e pylltarisë, dhe mandatin e përgjegjësitë ligjore të APK-së në menaxhimin e sektorit pyjor, dhe sfidat që dalin nga kjo, planifikojmë që gjatë vitit 2024 t'i kushtojmë vëmendje të veçantë edhe trajnimit të stafit. Kjo nevojë bëhet e domosdoshme duke pasur parasysh zhvillimet e hovshme shkencore e teknike të cilat janë duke ndodhur sot në botë, dhe të cilat duhet të përcillen aktivisht, me qëllim të rritjes së efektivitetit dhe efikasitetit, si dhe performancës të stafit në punë.

Për vitin 2024 ne bashkpunim me DP te MBPZHR, planifikohet zhvillimi i këtyre trajnimeve:

### 12.1. Trajnimi i teknikëve të pylltarisë, (të DKR-ve dhe të NJKP)

Trajnimi do të përfshijë disa tema profesionale nga sfera e pylltarisë, si p.sh: Vlerësimi i grumbullit pyjor, damkimin e drunjëve, aktivitetet silvikulturore etj.

Numri i pjesëmarrësve: 50

Kohëzgjatja: 3 ditë

Vendi: Blinajë

Trajnimin e mban stafi profesional i DP dhe APK-se.

### 12.2 Trajnimi i zyrtareve të DKR-ve , në sferën e menaxhimit të NjMP, procedurave administrative, raportuese etj

Temat: Planifikimi i aktiviteteve në pyje dhe toka pyjore, si dhe mënyrat e raportimit, shfrytëzimit të pyjeve, menaxhimi dhe administrimi i fletëparaqitjeve nga rojet e pyllit etj.

Numri i pjesëmarrësve: 30

Kohëzgjatja: 3 ditë

Vendi: Blinajë

Trajnimin e mban stafi profesional dhe menaxherial i DP-se dhe APK-se.

### 12.3 Trajnimi i inxhinierëve të pylltarisë

Temat: Të arriturat e fundit shkencore në zhvillimin dhe menaxhimin e sektorit të pylltarisë, shfrytëzimi i biomasës dhe ndikimi i ndryshimeve klimatike globale dhe roli i pyjeve, duke përfshirë metodat më të avancuara në menaxhimin dhe administrimin e pyjeve, për përdorimim e paisjeve matëse/monitoruese, për vlerësimin e shërbimeve mjedisore flores/faunes, hartimin e projektit të PPJD, mbrojtjen e pyjeve nga dëmtuesit, vlerësimin e asortimenteve drusore sipas standarteve evropiane, hartimin e planeve operative vjetore, bashkëpunim me komunitetin, rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit. Nevojat për trajnime (trajnimet) do të organizohen dhe mbahen në VGJRV në Blinajë,

Numri i pjesëmarrësve: 20

Kohëzgjatja: 15 ditë

Vendi: Blinajë

Për realizimin e programit të trajnimeve për stafin profesional do të angazhohen ekspertë nga vendet tjera, si dhe do të kontaktojmë edhe me donatorë potencial dhe partnerë ndërkombëtar të cilët mund të na ndihmojnë në këtë sferë.

Në rastin e angazhimit të ekspertëve të huaj, DP dhe APK do të kontaktojnë me donatorët që kjo kosto të mbulohet nga ta.

Realizimi i këtij plani ka kosto financiare buxhetore, andaj realizimi i tij do të varet direkt nga sigurimi i mjeteve financiare .

#### 12.4 Organizimi i vizitave studimore në vendet e rajonit dhe më gjerë

Kjo varet nga mundësitë financiare buxhetore të APK-se, dhe konsiderojmë se është e domosdoshme realizimi i tyre, për shkak të zhvillimit profesional të stafit të APK-se. Me qëllim të vendosjes së bashkëpunimit me institucionet simotra, këmbimit të përvojave, dhe avancimit të nivelit të ekspertizës profesionale, si dhe në bashkëpunim edhe me donatorë potencial dhe organizatat ndërkombëtare që veprojnë në sektorin e pylltarisë në Kosovë, për stafin menaxherial e profesional të APK-se, planifikohet të organizohen vizita studimore në ndonjë nga vendet e rajonit (Shqipëri, Maqedoni Veriore, Mali i Zi, Kroaci, Slloveni, Turqi) dhe më gjerë.

12.5 Furnizimi me pajisje mobile të IT me sistem të avancuar për nevojat ditore të punës së stafit profesional në terren;

Lidhur me këtë, ekziston mundësia që të kontribuojë edhe projekti aktual i financuar nga Suedia dhe BE, dhe i implementuar nga FAO.

### 13. KOSTOJA FINANCIARE (Të hyrat dhe shpenzimet) E PVMP 2024

Realizimi i suksesshëm i PVMP 2024 do të varet nga mundësitë e financimit të tij. DMP e ka ngritur këtë çështje në vazhdimësi, duke përfshirë diskutimet në takimet e stafit të lartë të APK-së, dhe në takimet e përbashkëta të stafit të lartë të APK-se me drejtorët e DKR-ve.

Ndërsa, sa i përket mbrojtjes së pyjeve nga faktoret abiotik apo mekanik, është planifikuar ngritja e 36 vrojtoreve, rregullimi 9 ujëmbledhësve, për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret janë planifikuar 5,916 ditë pune kujdestarie.

DMP, shprehë shqetësimin në vazhdimësi rreth aktiviteteve dhe projekteve të cilat janë të përfshira në PVMP për vitin 2024, dhe për të cilat nuk ka mbështetje financiare. Për këtë arsye, duhet që të gjendet një zgjidhje rreth financimit të këtyre aktiviteteve, pra të gjenden burimet financiare. Në të kundërtën, rrezikohet që PVMP 2024, nuk do të realizohet konform parametrave të planifikuara.

Edhe këtë vit APK ka planifikuar edhe koston financiare të kryerjes së aktiviteteve, dhe po ashtu ne baze të pranimit të formulareve nga DKR-te ka evidentuar edhe të hyrat e planifikuara, të cilat gjenden në tabelen e më poshtme.

Tabela, kostoja financiare (te hyrat dhe shpenzimet ne euro):

Të hyrat/Euro	Prishtina	Mitrovica	Peja	Prizreni	Ferizaji	Gjilani	DHPPF	DMKEKGJKET	Totali
Shfrytëzimi i pyjeve nepermjet tenderimit	100,092.50	266,565.00	33,328.80	6,530.90	328,681.11	450,275.80	-	141,550.60	1,327,014.71
Shfrytëzimi i pyjeve me shitje per ekonomit familjare	26,624.18	38,652.84	20,417.40	90,876.00	39,918.40	80,226.00	-	-	296,714.62
Të hyrat nga shfrytëzimi i Pyjeve në pronësi Shtetërore	126,716.68	305,207.84	53,746.20	97,406.90	368,599.51	530,501.80	-	141,550.60	1,623,728.53
Të hyrat nga shfrytëzimi i Pyjeve në pronësi Private,	61,930.00	162,100.00	16,790.00	10,830.00	32,100.00	81,200.00	-	1,900.00	366,850.00
I - Të hyrat nga shfrytëzimi i Pyjeve nga te dy sektorët	188,646.68	467,307.84	70,536.20	108,236.90	400,699.51	611,701.80	-	143,450.60	1,990,579.53
II - Të hyrat nga Konfiskimet e masës drusore	14,000.00	9,325.00	17,150.00	-	20,000.00	-	-	-	-
III - Të hyrat nga dhënia me qira	-	84,442.30	214,642.00	269,407.40	193,888.00	206,364.00	-	-	968,753.70
IV - Te hyra të tjera	-	1,700.00	-	-	-	-	-	-	1,700.00
<b>Gjithsej te hyrat nga I+ II+III+IV</b>	<b>202,646.68</b>	<b>562,775.14</b>	<b>302,328.20</b>	<b>377,644.30</b>	<b>614,597.51</b>	<b>818,065.80</b>	<b>-</b>	<b>143,450.60</b>	<b>3,023,538.23</b>
	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Shpenzimet:</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-
I - Shpenzimet në mbrojtje te pyjeve	46,000.00	13,250.00	91,500.00	268,750.00	116,500.00	96,500.00	-	50,200.00	680,700.00
II - Trajtimi i pyjeve te reja, rralime paratroglare	-	33,800.00	35,000.00	-	38,500.00	43,150.00	-	-	150,450.00
III - Planet Menaxhuese Pyjore	-	102,074.70	35,287.00	109,206.37	88,747.20	129,129.00	-	15,204.00	479,648.27
IV - Shpenzimet për ngritjen e pyjeve te reja	-	56,250.00	-	74,111.00	36,400.00	38,675.00	-	126.75	205,562.75
Shpenzime (investime) në I+II+III+IV	46,000.00	205,374.70	161,787.00	450,067.37	280,147.20	307,454.00	-	65,530.75	1,516,361.02
Gjithsej shpenzime (teknike, paisje, etj)	56,725.00	5,100.00	4,500.00	29,800.00	3,400.00	52,000.07	-	-	151,525.07
Gjithsej shpenzimet tjera, puntor dhe sipas nevojave te DK	-	-	-	82,500.00	19,500.00	12,000.00	54,000.00	24,000.00	192,000.00
<b>Gjithsej shpenzime ne APK</b>	<b>102,725.00</b>	<b>210,474.70</b>	<b>166,287.00</b>	<b>562,367.37</b>	<b>303,047.20</b>	<b>371,454.07</b>	<b>54,000.00</b>	<b>89,530.75</b>	<b>1,859,886.09</b>



**Kostoja financiare sipas kërkesave të pranuar nga DKR-të**

Aktivitetet		Njësia matëse	Gjithsej vëllimi m3	Gjithsej ne euro (€)
Shfrytëzimi i Pyjeve Shtetërore-Tender	Dru teknik fletor	m3	€ 8,438.69	€ 412,358.45
	Dru zjarri fletore	m3	€ 30,289.00	€ 770,926.61
	Dru teknik halore	m3	€ 1,288.22	€ 75,229.20
	Dru zjarri halor	m3	€ 2,373.25	€ 54,130.45
	Mbetje drunore	m3	€ 1,993.10	€ 14,370.00
Shfrytëzimi i Pyjeve Shtetërore-shitje e lire	Dru teknik fletor	m3	€ 180.00	€ 11,700.00
	Dru zjarri fletor	m3	€ 14,428.38	€ 255,994.98
	Dru teknik halor	m3	€ 99.50	€ 6,965.00
	Dru zjarri halor	m3	€ 438.88	€ 7,114.84
	Dru te tharë	m3	€ 987.50	€ 14,940.00
<b>Të hyrat nga Pyjet Shtetërore</b>			<b>€ 60,516.52</b>	<b>€ 1,623,729.53</b>
Shfrytëzimi i Pyjeve Private (te hyrat na taksat e sherbimeve)	Dru teknik	m3	€ 21,390.00	€ 64,170.00
	Dru zjarri me dm mbi 7cm	m3	€ 151,340.00	€ 302,680.00
	Dru zjarri me dm nën 7 cm	m3	€ 0.00	€ 0.00
<b>Të hyrat nga Pyjet Private,</b>			<b>€ 172,730.00</b>	<b>€ 366,850.00</b>
Konfiskimi i masës drusore	Dru teknik	m3	€ 265.00	€ 14,325.00
	Dru zjarri	m3	€ 1,530.00	€ 46,150.00
<b>Të hyrat nga Konfiskimet e masës drusore</b>			<b>€ 1,795.00</b>	<b>€ 60,475.00</b>
<b>I - Të hyrat nga shfrytëzimi i Pyjeve</b>			<b>€ 235,041.52</b>	<b>€ 2,051,054.53</b>
<b>II - Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës shtetërore</b>				
Të hyrat nga Kontratat e Qeras (shfrytëzimi i pronës shtetërore)	Gurore\Miniera,	m2	€ 3,916,907.00	€ 783,381.40
	Objekte te përkohshme, (gastronomi, rruge, parkingje, obj. Rekreative, stabilimente për energji, hidrocentral etj.),	m2	€ 667,822.00	€ 133,564.40
	Objekte te përkohshme skaj rrugëve,	m2	€ 17,667.00	€ 5,300.10
	Antena,	copë	€ 10.00	€ 2,240.00
	K. Bujqësore\Kulloza\Pemë frutore,	ha	€ 925.96	€ 46,297.80
<b>II - Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës shtetërore</b>				<b>€ 970,783.70</b>
<b>III - Të hyra të tjera</b>	Te specifikohet sipas nevojave te DKR-ve dhe DHPPP. Nga Hartimi i Projekteve\programeve per rikultivimin e sipërfaqeve pyjore, si dhe projekteve tjera sipas kërkesave		€ 5.00	€ 1,700.00
<b>Gjithsej te hyrat nga shitja e mases drusore I + II+III</b>				<b>€ 3,023,538.23</b>

Aktivitetet		Njësia matëse	Gjithsej sipërfaqja ha\cope\metër	Gjithsej ne euro (€)
Mbrojtja e Pyjeve	MP nga faktorët biotik (forma e trajtimit mekanike apo pesticide)	hektar (ha)	€ 1,124.00	€ 168,500.00
	Ngritja e drurëve kurth	copë	€ 100.00	€ 9,000.00
	Ngritja e vrojtoreve	copë	€ 1,525.00	€ 63,500.00
	Rregullimi ujëmbledhësve	copë	€ 35,009.00	€ 122,000.00
	Hapja e rrugëve të reja	metër gjatësi	€ 8,008.50	€ 68,000.00
	Mirëmbajtje të rrugëve ekzistuese të plote (shtrim gjithë rrugës, pastrim kanalesh etj.)	metër gjatësi	€ 11,009.00	€ 186,500.00
	Mirëmbajtje të rrugëve ekzistuese (mbushje gropa, pastrim kanalesh)	metër gjatësi	€ 17,583.50	€ 63,200.00
<b>Shpenzimet në mbrojtje të pyjeve</b>				<b>€ 680,700.00</b>

Aktivitetet/Projektet kapitale		Njësia matëse	Gjithsej sipërfaqja	Gjithsej ne euro (€)
<b>I - Trajtimi i pyjeve të reja, rrallime paratregtare</b>		hektar (ha)	€ 256.30	€ 150,450.00
<b>II - Planet Menaxhuese Pyjore (sipas llojit të metodologjisë aktuale të aplikuar)</b>		Hektar	€ 67,936.50	€ 479,648.27
Pyllëzim i sipërfaqeve të zhveshura		hektar (ha)	€ 90.03	€ 98,526.00
Ripyllëzime		hektar (ha)	€ 0.15	€ 126.75
Pyllëzime plotësuese (plotësim i kulturave, pyjeve degraduara, shkurreve etj.)		hektar (ha)	€ 0.00	€ 0.00
Mirëmbajtja e pyllëzimeve (mirëmbajtja korizë 3 vjeçare, planifikimi i mirëmbajtjes për vitin 1, 2 dhe 3, si dhe llojet dhe mënyrat e mirëmbajtjes)		Hektar (ha)	€ 135.03	€ 123,810.00
<b>III - Shpenzimet për ngritjen e pyjeve të reja</b>				<b>€ 222,462.75</b>
<b>Gjithsej investime kapitale I+II+III</b>				<b>€ 1,533,261.02</b>

Kërkesat	Njësia matëse	Gjithsej cope\persona	Gjithsej ne euro (€)
Blerja e veturave	copë	€ 6.00	€ 141,000.00
Pajisje profesionale të terrenit (specifikoni llojet)	copë	€ 89.00	€ 25,525.07
<b>Gjithsej kapitale</b>			<b>€ 166,525.07</b>

Aktivitetet	Njësia matëse	Gjithsej persona	Gjithsej ne euro (€)
Punëtorë sezonal dhe kujdestari aktive të angazhuar në mbrojtjen e pyjeve dhe aktivitete silvikulturore	persona	€ 190.00	€ 120,750.00
Shpenzimet e tjera (të specifikohet sipas nevojave të DKR-ve)	persona	€ 29.00	€ 71,250.00
<b>Gjithsej shpenzimet</b>			<b>€ 192,000.00</b>

Në kuadër të 'Të hyrave' janë evidentuar dhe llogaritur të hyrat nga, Shfrytëzmi i pyjeve shtetërore nëpërmjet tenderimit dhe shitjes për ekonomitë familjare, si dhe të hyrat nga taksat e pyjeve private, të hyrat nga konfiskimet dhe të hyrat nga dhënia e tokave pyjore me qera si dhe të hyrat të tjera.

Ndërsa sa i përket pjesës së shpenzimeve, janë shpenzimet në mbrojtjen e pyjeve nga faktorët biotik dhe abiotik, trajtimin e pyjeve të reja (rrallime paratregtare), investimet në hartimin e planeve menaxhuese pyjore dhe ngritjen e pyjeve të reja (pyllëzimeve) dhe të mirëmbajtjes. Po

ashtu tek shpenzimet janë llogaritur edhe shpenzime për paisje teknike, si makina terreni dhe paisje tekniket profesional për terren, si dhe shpenzimet për puntorët sezonal dhe kujdesatari aktive dhe nevojat tjera të DKR-ve. Të dhënat e detajuara janë në tabelën e mësipërme.

Me qëllim të sigurimit të koherences së plotë në mes të dokumenteve: PVMP, KASH dhe kërkesës buxhetore, si dhe në përputhje me planin e punës të DMP-së, dhe qëndrimin e DMP-se të shprehur fillimisht në takimin e stafit udhëheqës të APK-se, këtë vit procesi i përgatitjes së PVMP është zhvilluar kështu:

## ANEKSE

Plani Vjetor i Menaxhimit me Pyje për vitin 2023 përbëhet nga kapitujt e poshtëshënuar, të cilat njëkohësisht janë edhe plane në vetëvete (9 kapitujt përbëhen nga forma tabelore):

1. Kultivimi i pyjeve;
2. Trajtimi (Shfrytëzimi) i pyjeve në Ngastra;
  - *Shfrytëzimi i ngastrave nëpërmjet tenderimit dhe shitjes së masës drusore për furnizim me dru djegie për nevoja familjare;*
  - *Prodhimi neto, ndarja sipas asortimenteve drusore dhe prodhimi bruto, prerjet sipas NjKP;*
  - *Prerjet sipas llojeve të trajtimeve;*
3. Aktivitetet në trajtimin e pyjeve të reja (rrallime paratregtare, pastrime etj.);
4. Pyllëzimet;
5. Prodhimi i fidanëve dhe gjendja e stokut ;
6. Aktivitetet në pyje private;
7. Mbrojtja e pyjeve;
8. Hartimi i Planeve Menaxhuese Pyjore (Planeve Afatgjata);
9. Infrastruktura pyjore;
10. Shfrytëzimin e produkteve pyjore jodrunore;
11. Gjuetia;
12. Trajnimet;
13. Kostoja financiare.

### KULTIVIMI I PYJEVE

Nr. rëndor	PËRSHKRIMI I PUNIMEVE	Drejtorati Koordinues Regjionale							
		Prishtinë	Mirtovicë	Pejë	Prizren	Ferizaj	Gjilan	DMKEKGJET	Gjithsej
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9 (2+8)
<b>A</b>	<b>KULTIVIMI DHE PËRTERITJA E PYJEVE</b>	<b>176,50</b>	<b>268,00</b>	<b>80,00</b>	<b>595,50</b>	<b>85,00</b>	<b>192,90</b>	<b>12,00</b>	<b>1 409,90</b>
1	Punët përgatitore dhe masat ndihmëse për përtëritje e pyjeve	20,00	3,00	-	65,60	-	6,60	12,00	107,20
1,1	Pastrimi i rrugëve (shtigjeve) pyjore/meter				45 000,00				45 000,00
1,2	Rigjenerim Natyral me pëgatitje terreni fletore								-
1,3	Rigjenerim Natyral me pëgatitje terreni halore								-
1,4	Rigjenerim Artificial me pëgatitje terreni fletore								-
1,5	Rigjenerim Artificial me pëgatitje terreni halore								-
1,6	Rigjenerim pa përgatitje terreni								-
1,7	Vendosja e rendit pyjor				65,60				65,60
1,8	Pastrimi i brezave ekzistues (kunder zjarrit etj.)		2,00				3,50	12,00	17,50
1,9	Hapje te brezave kunder zjarrit ne pyje	20,00	1,00				3,10		24,10
1.10.	Sanimi i sipërfaqeve të djegura								-
2	<b>Trajtimi i kulturave pyjore te reja</b>	-	-	<b>30,00</b>	-	<b>30,00</b>	<b>40,00</b>	-	<b>100,00</b>
2,1	Pyllëzimi plotësues /farim (plotësimi i kulturave pyjore)								-
2,2	Mirmbajtëja e pyllzimeve (drejtim te f., shtypje, rrehimie dhe perhimia)			30,00		30,00	40,00		100,00
3	<b>Trajtimi i pyjeve te reja</b>	<b>156,50</b>	<b>265,00</b>	<b>50,00</b>	<b>529,90</b>	<b>55,00</b>	<b>146,30</b>	-	<b>1 202,70</b>
3,1	Çlirime/pastrime	15,00	200,00		529,90		60,00		804,90
3,2	Trajtimi me çeltira dhe breza				-				
3,3	Rrallime Paratregtare	141,50	65,00	50,00	-	55,00	86,30		397,80
<b>B</b>	<b>TRAJTIMI I PYJEVE</b>	<b>488,10</b>	<b>1 350,06</b>	<b>1 203,25</b>	<b>696,70</b>	<b>1 219,50</b>	<b>283,88</b>	<b>167,61</b>	<b>5 409,10</b>
1	Rrallime në pyje te larta (trungishte)	234,10	640,62	28,60	269,40	680,90	34,30		1 887,92
2	Rrallime në pyje te ulta (cungishte/lastarore)	162,00	634,44		298,10	165,20	200,60	166,10	1 626,44
3	Prerje rigjeneruese njëmoshore (prerje <i>perfundimatare, drure faror, prerje ne vrune</i> )	45,00		20,00	52,70	40,10			157,80
4	Prerje rigjeneruese shummoshore (dru i <i>vetem ose selektim ne vrune</i> )	26,60			65,20	192,20	24,20		308,20
5	Prerje Sanitare (drure te demtuara nga faktoret <i>biotik apo abiotik</i> )	20,40	75,00	1 149,65	11,30	141,10	24,78		1 422,23
6	Konvertim								-
7	Prerje me Shirita (breza)							1,51	1,51
8	Prerje ne formë rrethore			5,00					5,00
<b>C</b>	<b>NGRITJA E PYJEVE TE REJA</b>	<b>10,00</b>	<b>15,00</b>	<b>20,00</b>	<b>25,03</b>	<b>20,00</b>	<b>15,00</b>	-	<b>105,03</b>
1,1	Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura me fletore	10,00			-				10,00
1,2	Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura me halore		15,00	20,00	25,03	20,00	15,00		95,03
1,3	Ripyllëzim me fletore								-
1,4	Ripyllëzim me halore								-
<b>G J I T H S E J ( A + B + C ) :</b>		<b>674,60</b>	<b>1 633,06</b>	<b>1 303,25</b>	<b>1 317,23</b>	<b>1 324,50</b>	<b>491,78</b>	<b>179,61</b>	<b>6 924,03</b>

**SHFRYTEZIMI I PYLLIT NË NGASTËR**  
 furnizimi me dru per djegie per nevoja familjare

Nr.	Njësia e APK-se / Njësia Menaxhuese	Ngastra/ Nergastra	Sipërfaqja totale / ha	Sipërfaqja për trajtimit / ha	Lloji i drurit	Trajtimi	Vëllimi dronore bruto m³	Asortimentet neto m³			Mbetje dronore m³	
								teknik fletor	teknik halor	dru zjarr		Gjithsej
0	1	2	3	4	5	6	7 (11+12)	8	9	10	11 (8+9+10)	12
1	Mçqëglavë-Dubok	39	47,80	20,00	Shkozë	Rrallime	100,00	-	-	95,00	95,00	5,00
2		27,00	39,50	15,00	Ah.	Rr.rigi,njemosh	322,80	-	-	307,53	307,53	15,27
3		49,50	106,20	20,00	Ah	Rrall hap korid	120,00	-	-	114,00	114,00	6,00
4	Prishtina I	74,00	38,50	26,80	Ahu dhe fletorë tjer	Rrallime	280,00	-	-	266,00	266,00	14,00
5		18,19	133,90	15,00	Bung. Qarr	Rrallime	120,00	-	-	114,00	114,00	6,00
<b>Nj. Komunale Prishtinë - Gjithsej:</b>		118	365,90	96,80	-	-	942,80	-	-	896,53	896,53	46,27
6	Popovë-Lipashicë	94	47,00	20,00	Ah dhe fl. tjerë	Rrallime	150,00	-	-	142,50	142,50	7,50
7	Turuqicë	94	17,60	5,10	Shkozë dhe fl të tj.	Rrallime	120,00	-	-	114,00	114,00	6,00
<b>Njësia Komunal Podujevë - Gjithsej:</b>		35	60,60	30,00	Ahu, fl tjerë	Rrallime	84,00	-	-	79,80	79,80	4,20
8	Pyjet e Drenicës	68	30,20	15,00	Shkozë, fl tjerë	Rrallime	70,00	-	-	66,50	66,50	3,50
<b>Njësia Komunal Lipjan - Gjithsej:</b>		26	28,40	10,00	Bung. Qarr	Rrallime	63,00	-	-	59,85	59,85	3,15
9	Prishtina III	15	50,00	15,00	Bung. Qarr	Rrallime	60,00	-	-	57,00	57,00	3,00
<b>Njësia Komonale Obiliq</b>		15	50,00	15,00	Bung. Qarr	Rrallime	60,00	-	-	57,00	57,00	3,00
<b>Gjithsej:DKR Prishtinë</b>			599,70	191,90	-	-	1.489,80	-	-	1.416,18	1.416,18	73,62
1	Slakovc	Jasht Planit M	28,00	28,00	Ahu	Rrallim	150,00	-	-	142,50	142,50	7,50
<b>Gjithsej NJ.K. Vushtri</b>			28,00	28,00	-	-	150,00	-	-	142,50	142,50	7,50
2	Z.Kadastrale Gramiqane	Ngastra 40	32,00	15,00	Ahu	Pastrime	61,58	-	-	58,50	58,50	3,08
3	Z.Kadastrale Berberisht	Ngastra 45	40,00	12,00	Hormoq	pastrime	35,05	-	-	33,30	33,30	1,75
<b>Gjithsej NJ.K. Leposaviq</b>			72,00	27,00	-	-	96,63	-	-	91,80	91,80	4,83
4	Njësia Menaxhuese Barel	Jasht Planit M	164,00	164,00	Ahu	Pastrime Qlirime	100,00	-	-	95,00	95,00	5,00
5	Njësia Menaxhuese Barel	Jasht Planit M	315,00	315,00	Ahu+F.tjer	Rrallim	1.200,00	-	-	1.140,00	1.140,00	60,00
6	Kopaunik/Lomovë/	29,30	15,00	15,00	Ahu	Pastrime	250,00	-	-	237,50	237,50	12,50
7	Kqiq	Jasht Planit M	30,00	30,00	Pish B+Z	Prekje Sanitare	13,77	-	-	13,08	13,08	0,69
8	Zabersh+Deakove	Jasht Planit M	234,00	234,00	Ahu	Rrallim	200,00	-	-	190,00	190,00	10,00
<b>Gjithsej NJ.K. Mitrovicë</b>			758,00	758,00	-	-	1.763,77	-	-	1.675,58	1.675,58	88,19
9	Dubocak	2,3	109,00	109,00	Dushku	Rrallim	250,00	-	-	237,50	237,50	12,50
<b>NUM. Dubocak:</b>			109,00	109,00	-	-	250,00	-	-	237,50	237,50	12,50
<b>Gjithsej:DKR Mitrovicë</b>			967,00	922,00	-	-	2.260,40	-	-	2.147,38	2.147,38	113,02



Nr.	Njësia e APK-së / Njësia Menaxhuese	Ngastrat Nerrngastrat	Sipërfaqja totale / ha	Sipërfaqja për trajtimit / ha	Lloji i dritit	Trajtimi	Vëllimi dritore bruto m³	Asortimentet në m³				Mbetje dritore m³
								teknik fletor	teknik halor	dru zjarr	Gjithsej	
1	Radush	076/01,02,03,04	28,60	20,07	Ahu	Rrallim	966,70			918,90	918,90	48,03
2		Përgjat Njësise			Breut	Sanitare	190,00			171,00	171,00	19,00
<b>Njësia Komunale Istog - Gjithsej:</b>			<b>28,60</b>	<b>20,07</b>			<b>1 156,70</b>			<b>1 089,90</b>	<b>1 089,90</b>	<b>67,03</b>
3	Maja	Përgjat Njësise	286,96	286,96	Bung /Qarr, Ahu	Pastrim Sanitare	1 100,00			990,00	990,00	110,00
4	Çerreti	Përgjat Njësise	138,75	138,75	Bung /Qarr, Ahu	Pastrim Sanitare	620,00			538,00	538,00	62,00
5	Dushkaja	Përgjat Njësise	50,00	50,00	Bung /Qarr, Ahu	Pastrim Sanitare	150,00			135,00	135,00	15,00
6		077, 02	38,80	38,80	Pishe e Zezë	Pastrim Sanitare	14,80			13,30	13,30	1,50
7	Pashtriku	127, 01.	25,20	25,20	Pishe e Zezë	Pastrim Sanitare	8,20			7,40	7,40	0,80
8	Maja	59	5,00	5,00	Gështenje	Pastrim Sanitare	80,00			72,00	72,00	8,00
<b>Njësia Komunal Gjakovë - Gjithsej:</b>			<b>544,71</b>	<b>544,71</b>			<b>1 973,00</b>			<b>1 775,70</b>	<b>1 775,70</b>	<b>197,30</b>
9		118	26,90	26,90	Bung /Qarr	Pastrim Sanitare	36,00			32,40	32,40	3,60
10		126	28,00	28,00	Bung /Qarr	Pastrim Sanitare	30,00			27,00	27,00	3,00
11		129	35,07	35,07	Bung /Qarr	Pastrim Sanitare	40,00			36,00	36,00	4,00
12		130	59,45	59,45	Bung /Qarr	Pastrim Sanitare	35,90			31,50	31,50	3,50
13		131	62,39	62,39	Bung /Qarr	Pastrim Sanitare	37,00			33,30	33,30	3,70
14	Klinë	133	32,20	32,20	Bung /Qarr	Pastrim Sanitare	28,00			25,20	25,20	2,80
15		134	49,03	49,03	Bung /Qarr	Pastrim Sanitare	14,00			12,60	12,60	1,40
16		135	40,70	40,70	Bung /Qarr	Pastrim Sanitare	17,00			15,30	15,30	1,70
17		136	30,80	30,80	Bung /Qarr	Pastrim Sanitare	23,00			20,70	20,70	2,30
18		137	47,13	47,13	Bung /Qarr	Pastrim Sanitare	13,00			11,70	11,70	1,30
19		140	47,13	47,13	Bung /Qarr	Pastrim Sanitare	40,00			36,00	36,00	4,00
<b>Njësia Komunal Klinë - Gjithsej:</b>			<b>458,80</b>	<b>458,80</b>			<b>313,00</b>			<b>281,70</b>	<b>281,70</b>	<b>31,30</b>
<b>Gjithsej DKR Pejë</b>			<b>1 032,11</b>	<b>1 023,58</b>			<b>3 442,70</b>			<b>3 147,30</b>	<b>3 147,30</b>	<b>295,63</b>
1		28/02	25,20	15,10	Ahu	Rrallime	49,00			46,55	46,55	2,45
2		30	54,00	54,00	Shkozë	Pastrim/Çlirim	60,00			57,00	57,00	3,00
3		75/01	30,00	25,00	Ahu	Rrallime	134,80			128,06	128,06	6,74
4	Nj.M."KORITNIK I"	79/01	4,40	4,40	Ahu	Rrallime	39,00			37,05	37,05	1,95
5		85/05	11,70	11,70	Ahu	Rrallime	58,50			55,58	55,58	2,93
6		68/01	47,48	10,00	Ahu	Rrallime	93,30			88,64	88,64	4,67
7		98/01	12,80	12,80	Ahu	Preje rigi shumemosh	127,20			120,84	120,84	6,36
8		100 111 115/00	5,00	5,00	Ahu	Sanitare	75,00			71,25	71,25	3,75
9	Nj.M. "PASHTRIK I"	61/02;132/01	54,40	10,00	Ahu	Rrallime	231,40			219,83	219,83	11,57
10		138/01,03	19,00	11,40	Ahu	Rrallime	129,10			122,65	122,65	6,46
11		19/01	42,52	25,00	Ahu	Rrallime	125,60			119,32	119,32	6,28
12		20/01	37,23	14,89	Ahu	Rrallime	57,40			54,53	54,53	2,87
13	Nj.M. "MALET E SHARRIT"	22,23	51,32	41,06	Ahu	Preje rigi shumemosh, Rrallime	67,50			64,13	64,13	3,38
